



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr.677/7 prot.

Datë 03.04.2026

V E N D I M

Nr. 467/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.04.2026, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes së ankesës së operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, nga autoriteti kontraktor, në procedurën e prokurimit me nr.REF-76930-02-20-2026, me objekt: *“Implementimi i Sistemit të Ri Dixhital të Taksave dhe Tarifave Vendore”*, me fond limit 12,000,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 16-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.

Vazhdimi i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Operatori ekonomik “Kreatx” SHPK me NUIS L12121023B dhe adresë: Rruga “Robert Shvarc”, godina “Niku Constraksiun”, kati nr.1 teknik, hyrja nr.2, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlore.
Sheshi “4 Heronjte”, Vlorë

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 *“Për*

miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”; Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlllogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.02.2026, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me nr.REF-76930-02-20-2026, me objekt: “Implementimi i Sistemit të Ri Dixhital të Taksave dhe Tarifave Vendore”, me fond limit 12,000,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 16.03.2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.

II.2. Në datën 02.03.2026 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2026/6380, protokolluar me nr. 677/2026 prot, datë 03.03.2026 e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Konkretisht në ankesë pretendohet si vijon:

[...]

Së pari: Në specifikimet teknike që janë publikuar në dokumentin e veçantë bashkëlidhur DST nga AK, referohet për zbatim legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale. Kreatx SHPK konstaton se referohet për zbatim ligji nr.9887, datë 10.03.2008, ndërkohë që prej vitit 2024 ka hyrë në fuqi ligji nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Për pasojë, Kreatx SHPK vlerëson se, të gjitha kërkesat e posaçme të vendosura nga AK për mbrojtjen e të dhënave personale janë të paligjshme, sepse janë mbështetur në ligjin e shfuqizuar dhe në protokollin e vjetër për mbrojtjen e tyre. Aktualisht, ka hyrë në fuqi dhe zbatohet ligji nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, që bashkë me aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, ka ndryshuar rregullat e zbatueshme në fuqi dhe në këto kushte kuadri ligjor i zbatueshëm duhet të zëvendësohet nga AK në DST.

Së dyti: Në specifikimet teknike të publikuara në dokumentin e veçantë bashkëlidhur DST, për ruajtjen e dokumentave tatimore është shënuar afati i gabuar 5 – 10 vjet, ndërkohë që afati sipas nenit 179 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 48, pika 2, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2020, “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar, është vetëm 5 vjet. Vendosja e një afati të paligjshëm për ruajtjen e dokumentacionit në një sistem elektronik taksash vendore i bën specifikimet e DST në kundërshtim me ligjin dhe për pasojë Kreatx SHPK çmon se, afati në këtë rast duhet të zëvendësohet AK në përputhje me afatin që parashikon neni 48 i ligjit për procedurat tatimore.

Së treti: Në shtojcën nr.7, AK ka përcaktuar grafikun e shërbimeve dhe të ekzekutimit, që shërben edhe si tabelë orientuese për të depozituar ofertën ekonomike me zërat e shërbimeve për njësi dhe në total nga OE. Kreatx SHPK vëren se kjo tabelë është e pasaktë, pasi nuk kuptohet si janë ndarë zërat e mirëmbajtjes dhe të implementimit në raport me kohëzgjatjen e tyre. Kreatx SHPK e ka të pamundur që të kuptojë nëse kontrata zgjat 12 muaj apo 24 muaj, pasi AK nga njëra anë shprehet në DST se, afati i implementimit është 12 muaj, ndërsa nga ana tjetër citon se afati i mirëmbajtjes së sistemit të ri të implementuar është 12 muaj nga momenti që mbaron implementimi.

Ndërkohë, tabela e ofertimit është gjithashtu e paplotë, sepse nuk përmban afatin 12 mujor për implementimin siç kërkohet në përmbajtje të specifikimeve teknike bashkëlidhur DST. Kreatx SHPK thekson se, kjo paqartësi është thelbësore për ecurinë e zbatimit të kontratës dhe pamundëson mbarëvajtjen e prokurimit publik, duke sjellë si pasojë anulimin e tenderit, sipas nenit 98, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.

Tabela e grafikut të shërbimeve, të ekzekutimeve dhe të ofertimeve që ka vendosur AK paraqitet si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i Shërbimit	Vlera e Parashikuar Pa TVSH (ALL)
1.	Implementimin e Sistemit të ri të Taksave dhe Tarifave Vendore	
2.	Analizë dhe Migrim i të dhënave historike nga Microsoft Navision R2 në Sistemit të ri të Taksave dhe Tarifave Vendore	
3.	Testim, trajnime të stafit dhe dokumentacion	

4	Shërbim të dedikuar Cloud + Backup	
5	Mirëmbajtje dhe Mbështetje pas implementimit (12 muaj)	
	TOTALI pa TVSH	
	TVSH 20%	
	TOTALI pa TVSH	

Paqartësia e mësipërme për afatin e zbatimit të kontratës për një periudhë prej 12 muajsh, shoqërohet edhe me një problematikë tjetër në tabelën e ofertimit në DST, ku të dyja vlerat e shënuara brenda saj janë pa TVSH, ndonëse sipas LPP dhe RRPP vlerat e ofertës duhet të paraqiten në tabelë pa TVSH dhe me TVSH. Si rezultat, AK duhet të rregullojë edhe tabelën e ofertimit.

Së katërti: *Sa i takon grafikut të ekzekutimit që AK ka vendosur në DST, Kreatx SHPK vëren se është i paplotë, pasi është përgjysmë dhe përfshin vetëm 5 muajt e parë të ekzekutimit të kontratës, ndonëse shërbimet sipas kontratës presupozohen që të zgjasin për 12 apo 24 muaj. Pra, edhe në këtë drejtim AK duhet të plotësojë saktë DST.*

Grafiku i paplotë i ekzekutimit të shërbimeve që ka vendosur AK paraqitet si më poshtë: Shërbimet që kërkohen: 12 muaj

Afatet e ekzekutimit: 12 MUAJ

Faza	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5
Analiza & Blueprint	1	1	0	0	0
Zhvillimi Moduleve Bazë	0	1	1	1	0
Infrastruktura & Siguria	0	1	0	0	0
Integrimet	0	0	1	1	0
Migrimi i të Dhënave	0	0	1	0	0
Testimi	0	0	1	0	0
Trajnimet	0	0	0	1	0
Go-Live & Cutover	0	0	0	1	0
Hypercare	0	0	0	1	1

Përveç sa më lart, Kreatx SHPK vëren se, mes formularit të ofertës ekonomike dhe grafikut të ekzekutimit ka dallime sa i përket zërave të shërbimit që duhet të përmbushen nga kontraktori. Këto dallime janë të atij lloji që, i pamundësojnë OE ofertues të paraqesin një ofertë ekonomike në përputhje me LPP dhe RRPP dhe i pamundësojnë OE ofertues që të përlllogarisin saktë vlerën e ofertës ekonomike drejtuar AK. Këto mospërputhje dhe konfuzione mes grafikut të ekzekutimit dhe formularit të ofertës ekonomike dhe pasaktësitë e rënda në drejtim të zërave të ndryshëm të shërbimeve, shërbejnë si shkak që AK të rregullojë DST vetëm përmes anulimit të kësaj procedure prokurimi publik, sipas nenit 98, pika 1, shkronja “c”, të LPP, duke ngarkuar në SPE DST të reja dhe duke shpallur një prokurim të ri.

Së pesti: *Në shtojcën nr.9, pika 2, të DST, për numrin e punonjësve, AK përcakton se, operatori ekonomik duhet të disponojë një punësim mesatar të paktën 7 (pesëmbëdhjetë) punonjës të punësuar, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:*

Kreatx SHPK konstaton se, kërkesa e posaçme për numrin e punonjësve është e paqartë, pasi nuk kuptohet nëse bëhet fjalë për 7 apo 15 punonjës. Nëse bëhet fjalë për 15 punonjës, ky numër është i paargumentuar në DST, pasi AK nuk jep shpjegime mjaftueshëm për një kërkesë kaq të lartë punonjësish në raport me vlerën e prokurimit, nevojat e prokurimit dhe të AK, si dhe praktikën administrative të prokurimit publik në përgjithësi në Shqipëri. Për pasojë, kjo kërkesë e posaçme duhet të rregullohet nga AK, duke ulur numtin e punonjësve nga 15 që është përcaktuar dhe duke anuluar procedurën e prokurimit dhe duke zhvilluar një procedurë të re prokurimi nga e para.

Së gjashti: *Për kërkesat e vendosura në shtojcën nr.9, në lidhje me ISO, AK përcakton se, OE ofertues duhet të zotërojë midis të tjerave ISO 42001:2023 dhe ISO 22301:2019.*

Kreatx SHPK vëren se, ISO 42001:2023 është një ISO që certifikon subjektet tregtare për menaxhimin e inteligjencës artificiale, ndërsa ISO 22301:2019 është një ISO që certifikon subjektet tregtare për planet e menaxhimit të biznesit. Kreatx SHPK vëren se, vendosja e këtyre dy ISO-ve nga ana e AK është e pajustificuar dhe e paargumentuar nga AK për arsyet e mëposhtme:

1. Për ISO 42001:2023, në Republikën e Shqipërisë nuk ka asnjë subjekt tregtar të certifikuar për menaxhimin e inteligjencës artificiale. Për këtë mund të shikoni edhe faqen e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit dhe atë të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, që nuk kanë asnjë subjekt tregtar të certifikuar për këto ISO. Madje as nuk e njohin aspak një ISO të tillë.

2. Për më tepër, nga informacioni që disponon Kreatx SHPK, nuk rezulton të jetë ketë asnjë subjekt privat apo shtetëror të akredituar nga DPA në vendin tonë, që të inspektojë apo lëshojë certifikatë të tillë ISO. Duke mos u gjendur një certifikatë e tillë në tregun tonë të brendshëm, kuptohet që kërkesa e vendosur nga AK është e paligjshme, jokoherente në raport me situatën faktike duhet hequr nga DST.

3. Gjithashtu, nga përmbajtja e specifikimeve teknike të DST, AK e justifikon përdorimin e AI me faktin e përlllogaritjes së taksave vendore, me parashikimet për mbledhjen e tyre, me përgatitjen e dokumentave të kontrollit e të inspektimit të njësisë së taksave vendore pranë Bashkisë Vlorë, etj., veprime këto që janë të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, "Për sistemin e taksave vendore", të ndryshuar dhe në vendimet e Këshillit Bashkiak Vlorë, për të cilat nuk nevojitet përdorimi i AI, për sa kohë që i përcakton legjislacioni i zbatueshëm në fuqi mjaft mirë.

4. Në kushtet kur AI është thjesht një mjet ndihmës dhe nevojat që AK e justifikojnë përdorimin e AI për shërbime që janë të mirëpërcaktuara me ligj dhe akte nënligjore, vendosja e një ISO kaq të posaçme, thjesht kufizon konkurrencën për OE ofertues qëllimisht. Pra, jemi përpara një kufizimi të paligjshëm e të dëmshëm e me keqdashësi të konkurrencës në prokurimin publik.

5. Ndërkohë, ISO 22301:2019, nënkupton që OE ofertues të ketë planin e vazhdimin të biznesit në rast incidenti dhe si e tillë është një certifikim që nuk nevojitet për këtë prokurim publik, për sa kohë që me VKM nr.813, datë 30.12.2025, janë miratuar masat teknike, operacionale dhe organizative të operatorëve që disponojnë infrastruktura kritike dhe të rëndësishme. Sipas VKM nr.813/2025, çdo autoritet publik apo privat tashmë me stadardet e reja të sigurisë kibernetike, ka detyrimin ligjor që të respektojë dhe zbatojë këto masa, duke përfshirë ndër të tjera edhe një plan për vazhdimin e biznesit dhe një plan për Disaster Recovery. Për rrjedhojë,

vendosja e ISO 22301:2019 si një standard i posaçëm për ofertuesit, bie ndesh me kuadrin ligjor në fuqi, që i detyron operatorët ekonomikë ofertues t`a kenë një BCP në rastet kur implementojnë dhe mirëmbajnë sisteme të infrastrukturës të rëndësishme ose kritike.

6. Pra, për sa kohë që BCP është tashmë detyrim ligjor për subjektet tregtare në fushën e TIK dhe përbën një situatë të zakonshme, AK nuk mund t`a përdorë ISO 22301:2019 si standard kualifikues/skualifikues për ofertuesit gjatë prokurimit publik.

Për pasojë, AK nuk ka justifikuar vendosjen e këtyre ISO në DST dhe si të tilla ato duhet të hiqen nga dokumentacioni i tenderit, pasi të jetë anuluar procedura e prokurimit publik dhe të jetë 1% rishpallur në SPE në përputhje me LPP.

Së shtati: Në shtojcën nr.9 të DST, AK ka vendosur si kërkesa të posaçme certifikimet e punonjësve si më poshtë:

1. OE duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë Net ose ekuivalent me të paktën 3-5 vite ekperiencë.
2. OE duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë Oracle Database Administrator ose ekuivalent me të paktën 3-5 vite ekperiencë.
3. Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent.
4. Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert Database Administrator në Oracle dhe të certifikuar për Oracle Database 11g: SQL Fundamentals I (1Z0-051), Oracle Database Security Audit dhe Omega Core Audit.
5. Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert Backend Developer i certifikuar nga Google Cloud.
6. Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se ka në marrëdhënie bashkëpunimi të paktën një Ekspert në Sigurimin e Cilësisë së Softuerit (QA).
7. Ekspert në menaxhimin e projekteve (Ky nuk është vendosur fare tek certifikimet, por tek pjesa e argumentimit të vendosur në DST).

Kreatx SHPK vëren se për certifikimet me nr.1 dhe nr.2, kërkohet përvojë nga 3 deri në 5 vjet dhe mënyra e hartimit të kërkesës së posaçme është krejtësisht konfuze dhe e paqartë, edhe po të shohësh procesverbalin e argumentimit. Pra, në titullin e certifikimit të posaçëm AK ka caktuar përvojën prej 3 vjet, ndërsa në pjesën argumentuese të tij, certifikimi shënohet me përvojën 5 vjet. Këto paqartësi të dukshme përbëjnë shkelje të rënda të neneve 41 të LPP dhe 36 të RRPP, sipas të cilëve kërkesat e vendosura në DST duhet të jenë të qarta për ofertuesit, në përputhje me nevojat e AK, me qëllim që OE të ketë mundësinë të paraqesë ofertën ekonomike sipas LPP.

Në shtesë të argumentave më lart, vendosja e përvojës për punonjësit e certifikuar është paksa kontradiktore, pasi AK nuk e mat dot përvojën mbi bazë certifikimi, por vetëm mbi bazë vjetërsie pune. Kjo pasi, ka punonjës që mund të jenë certifikuar, por nuk kanë ushtruar veprimtari për 3 apo 5 vjet me radhë për veprimtarinë që janë certifikuar. Pra, në praktikë, mbetet faktikisht e paprovuar nëse punonjësi ka përvojë 3 apo 5 vite për një certifikim të posaçëm. Nga ana tjetër, po një punonjës që ka 10 vjet që është certifikuar, e përmbush apo jo kërkesën e posaçme, n kushtet kur kërkon 3 – 5 vite përvojë për certifikim ? Një kufizim me 3 – 5 vjet përvojë për certifikim, është i pajustificuar në raport me nevojat e prokurimit, i

pajustificuar në raport me nevojat e AK, si dhe me vetë përcaktimet e LPP dhe RRPP. Theksojmë se, sipas KPP, certifikimet vendosen nga ana e AK për OE ofertues, me qëllim që AK të kuptojë nëse OE i ka apo jo kapacitetet për të përmbushur detyrimet kontraktore, e jo për të kufizuar në mënyrë abuzive konkurrencën në prokurimin publik siç ka vepruar Bashkia Vlorë në këtë rast.

Pra, AK duhet të ndryshojë DST dhe të heqë përvojën për certifikimet me nr.1 dhe nr.2 sipas argumentit të paraqitur në këtë ankim administrativ.

Përsa i përket kërkesës së posaçme për ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent, Kreatx SHPK vlerëson se ajo është hartuar gabim, pasi me një kërkesë të posaçme janë vendosur dy certifikime të ndryshme. AK duhet të kishte ndarë certifikimet CISO dhe CISA nga njëra-tjetra, për sa kohë që janë të ndryshme ose duhet të kishte shprehur për natyrën alternative të tyre, me qëllim që OE ofertues të kuptonin që plotësimi i njëjës prej tyre e bënte ofertën e ekonomike të kualifikueshme në raport me këtë kërkesë.

Përsa i përket kërkesës së posaçme për ekspert Database Administrator në Oracle dhe të certifikuar për Oracle Database 11g: SQL Fundamentals I (1Z0-051), Oracle Database Security Audit dhe Omega Core Audit, Kreatx SHPK vëren se kjo kërkesë e posaçme, nuk është e qartë, pasi nga mënyra sesi është shkruar në DST nuk kuptohet nëse kërkohen punonjës me certifikime alternative apo kumulative. Pra, nëse ofertuesi duhet të depozittojë dokumentacion për punonjës edhe si Oracle Database Security edhe si Oracle Database SQL edhe për Omega Core Audit apo mjafton që ofertuesi të paraqesë dokumentacion vetëm për njërin prej tyre, me qëllim që të përmbushet kërkesa e posaçme në DST.

Po kështu, AK nuk argumenton nevojën e tre certifikimeve të ndryshme, e madje nuk shpjegon as ekuivalencën mes tyre. Theksojmë se, nëse databaza e sistemit të taksave vendore pranë Bashkisë Vlorë do të jetë Oracle, nuk ka nevojë për sistem Omega Core Audit. Vendosja e katër certifikimeve të ndryshme në një kërkesë të posaçme, që duhen ndarë sipas LPP, sjell konfuzion dhe paqartësi për OE të cilët e kanë të pamundur për të ofertuar sipas LPP dhe RRPP. Kërkesa e certifikimit të trefishtë nuk justifikohet as në procesverbalin e argumentimit nga AK, e prandaj duhen rregulluar edhe një herë nga e para DST, duke anuluar këtë procedurë prokurimi dhe duke shpallur një të re në SPE.

Përsa i përket kërkesës së posaçme për ekspert Backend Developer të certifikuar nga Google Cloud, Kreatx SHPK vëren se kërkesa është abuzive, pasi AK ka vendosur një certifikim të dedikuar nga Google pa përdorur termin ekuivalent siç e kërkon neni 36 i RRPP. Po ashtu, kërkesa është e pajustificuar për nevojat e prokurimit publik, pasi certifikimet back-end janë të llojeve të ndryshme në tregun e lirë dhe nuk ka përse të jenë të dedikuar vetëm për Google, pasi AK nuk paraqet asnjë nevojë për shërbime nga Google. Duke qenë një certifikim i pajustificuar as në procesverbal dhe as nga nevojat e prokurimit publik, dallohet qartë se kërkesa e posaçme është vendosur nga AK në kundërshtim me LPP, me qëllimin e vetëm të kufizimit të OE ofertues për të marrë pjesë në prokurimin publik.

Sa i përket kërkesës së posaçme për ekspert në sigurimin e cilësisë së softuerit (QA), Kreatx SHPK vëren se nuk është argumentuar nevoja e një kërkesë të këtillë të tillë në procesverbalin

e argumentimit nga AK. Për pasojë, mbajtja e një kërkesë të tillë në DST duhet të argumentohet nga AK ose në të kundërt duhet të hiqet prej tyre.

Në lidhje me kërkesën e posaçme për ekspert në menaxhimin e projekteve, Kreatx SHPK konstaton se kjo kërkesë nuk është vendosur tek certifikimet, por vetëm tek pjesa e argumentimit të tyre në DST. Prandaj, AK duhet të rregullojë DST edhe sa i takon kësaj kërkesë të posaçme, me qëllim që DST të jenë transparente në raport me OE ofertues që kanë dëshirë të marrin pjesë në tender.

Së teti: Në shtojcën nr.9 të DST, AK ka përcaktuar se: “Për personeli nevojitet dorëzimi i këtyre dokumentave (...) Certifikata/Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar; Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B; Kontratë punë.; Cv; Kontratat e bashkëpunimit.”.

Kreatx SHPK çmon se, dokumentacioni i kërkuar për stafin është shkruar në mënyrë të paqartë për sa i përket kontratave të bashkëpunimit. Kjo pasi, sipas LPP dhe RRPP, OE ofertues që duan të marrin pjesë në tender kanë mundësi që të depozitojnë një ofertë ekonomike të vlefshme sa i takon stafit dhe personelit teknik në këto forma:

1. Duke disponuar punonjës me kontrata pune si punonjës të tyre;
2. Duke u bashkuar me një operator tjetër ekonomik ofertues për të siguar stafin e nevojshëm të certifikuar në mënyrë të plotë si BOE;
3. Duke u mbështetur tek kapacitetet e një operatori tjetër ekonomik, pa kaluar 50 % të detyrimeve kontraktore, që në masën mbi 50% të tyre duhet të përmbushen nga ofertuesi.

Duke ju referuar tre mënyrave të ofertimit siç përcaktojnë LPP dhe RRPP më lart, vendosja e një kërkesë të posaçme për të dëshmuar stafin e nevojshëm me kontrata bashkëpunimi, lë hapësira për abuzivitet nga OE ofertues, pasi ata mund të kontraktajnë staf të certifikuar sipas kërkesave të vendosura në DST me çdolloj personi, edhe nëse ky nuk rezulton si subjekt tregtar në qarkullimin civil sipas ligjit organik për tregtarët dhe shoqërinë tregtare. Kjo sjellje mund të bjerë në kundërshtim me legjislacionin e punës dhe rekomandimet e Inspektoratit të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, që nuk i legjitimon kontratat e bashkëpunimi me persona fizikë të papajisur me NUIS sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Vendosja e kontratave të bashkëpunimit kaq gjerë lë hapësirë për ofertime nga OE që shkelin legjislacionin e punës, me persona fizikë që nuk shlyejnë detyrimet e taksave, tatimeve dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Po ashtu, kjo mund të bëhet shkak që gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, AK të ndeshet me ofertues që nuk janë të pavarur, pasi i njëjti person fizik mund të kontraktohet me bashkëpunim për efekt të certifikimit të tij nga disa OE ofertues në tender.

Për rrjedhojë, AK duhet të sqarojë se në DST se do të pranohen të vlefshme vetëm ofertues kontrata bashkëpunimi të lidhura me persona fizikë tregtarë dhe jo çfarëdolloj personi fizik.

Së fundi; Në dokumentacionin e specifikimeve teknike bashkëngjitur DST, AK citon se, sistemi i taksave vendore të Bashkisë Vlorë do të përdorë AI për arsyet e mëposhtme: “XI. Integrimi i

një moduli të inteligjencës artificiale në Sistemin e ri të Taksave dhe Tarifave vendore të Bashkisë Vlorë. (...) Ky modul do të automatizojë procese kyçe si: Identifikimi i subjekteve tatimpaguese dhe verifikimi i të dhënave të tyre duke përdorur algoritme analitike. Parashikimi i të ardhurave, bazuar në të dhënat historike dhe modelet e konsumit apo veprimtarisë ekonomike. Zbulimi i rasteve anormale si mospërputhje, evazion potencial ose gabime në deklarime. Asistimi i qytetarëve përmes një asistenti inteligjent që ofron informacion në kohë reale, udhëzime dhe përgjigje automatike. Optimizimi i vendimmarrjes së administratës duke gjeneruar raporte të personalizuar dhe rekomandime. Përfitimet kryesore përfshijnë: Rritje të saktësisë në administrimin e të dhënave. Ulje të kostove operative dhe kohës së përpunimit. Rritje të besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve. Automatizim të proceseve të përsëritura dhe reduktim të gabimeve njerëzore. Në thelb, integrimi i AI ndihmon Bashkinë Vlorë të ndërtojë një sistem taksash dhe tarifash më të zgjuar, më efikas dhe më të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarëve.”

Nisur nga argumentimi për implementimin e AI në sistemin e taksave vendore Vlorë, Kreatx SHPK konstaton se, AI shërben si një mekanizëm lehtësues i punëve të përditshme, por AI nuk identifikon subjektet tatimpaguese, pasi kjo është detyrë e inspektorëve të taksave vendore në Bashkinë Vlorë. Po ashtu, AI nuk mund të parashikojë të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe as të zbulojë evazion fiskal apo gabimet në deklarimet tatimore, procedura këto që janë të mirëpërcaktuara në ligj. Për pasojë, implementimi i AI duhet të jetë plotësisht i argumentuar në DST nga AK.”.

II.3. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Në datën 09.03.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 677/1 prot., shkresa me nr. 4478/2 prot., datë 04.03.2026 me objekt: “Dërgim dokumentacioni”, bashkëngjitur Vendimi i KSHA-së nr.4478/1 prot., datë 04.03.2026 me objekt: “Vendim lidhur me ankesën me nr.protokolli 677/2026, datë 02.03.2026”. Sipas këtij vendimi rezulton se ankesa e sipërcituar është pranuar pjesërisht nga KSHA-ja.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr.677/2 prot., datë 18.03.2026 me objekt: “Kërkesë për informacion”, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor informacion si vijon: “[...]Në datën 09.03.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 677/1 prot., shkresa me nr. 4478/2 prot., datë 04.03.2026 me objekt: “Dërgim dokumentacioni”, bashkëngjitur Vendimi i KSHA-së nr.4478/1 prot., datë 04.03.2026 me objekt: “Vendim lidhur me ankesën me nr.protokolli 677/2026, datë 02.03.2026”. Sipas këtij vendimi rezulton se ankesa e sipërcituar është pranuar pjesërisht nga KSHA-ja, por në këtë vendim nuk përcaktohet konkretisht qëndrimi i KSHA-së për secilin nga pretendimet e ngritura nga ankimuesi, pra cilat pretendime janë pranuar dhe cilat prej tyre janë refuzuar.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e gjyqimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, autoriteti kontraktor të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e

mësipërme të prokurimit, shoqëruar me procesverbalin e argumentimit dhe miratimit të kritereve të veçanta për kualifikim e specifikimeve teknike si dhe informacion të saktë dhe të qartë për gjykimin e KSHA-së lidhur me secilin nga pretendimin e parashtruara në ankesën e paraqitur nga shoqëria “Kreatx” SHPK.”

II.6. Në datën 30.03.2026 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 677/3 prot., shkresa e autoritetit kontraktor Bashkia Vlorë nr.5959 prot., datë 26.03.2026 me objekt: “Dërgim informacioni për procedurën e prokurimit me objekt: “Implementimi i Sistemit të Ri Dixhital të Taksave dhe Tarifave Vendore””, bashkëngjitur shkresa nr. 5958 prot., datë 26.03.2026 e KSHA-së me objekt: “Dërgim informacioni në lidhje me gjykimin e KSHA-së për pretendimet e parashtruara në ankesën e paraqitur nga shoqëria “Kreatx” SHPK”. Referuar shkresës nr. 5958 prot., datë 26.03.2026, rezulton se KSHA ka pranuar pjesërisht pretendimet e ankimuesit si më poshtë vijon:

“[...] Ne si KSHA, pasi u njohëm me ankesën e depozituar nga operatori ekonomik dhe pas shqyrtimit të gjithë dokumentacionit të administruar në dosjen e tenderit për këtë procedurë dh ekritereve të vecanta t ekualifikimit sipas dokumentacionit përkatës si dhe kërkesës së KPP, po ju paraqesim konstatimet lidhur me pretendimet e paraqitura nga operatori ekonomik si më poshtë:

Pika 1- *Në specifikimet teknike që janë publikuar në dokumentin e veçantë bashkëlidhur DST nga AK, referohet për zbatim legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale. Kreatx SHPK konstaton se referohet për zbatim ligji nr.9887, datë 10.03.2008, ndërkohë që prej vitit 2024 ka hyrë në fuqi ligji nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Për pasojë, Kreatx SHPK vlerëson se, të gjitha kërkesat e posaçme të vendosura nga AK për mbrojtjen e të dhënave personale janë të paligjshme, sepse janë mbështetur në ligjin e shfuqizuar dhe në protokollin e vjetër për mbrojtjen e tyre. Aktualisht, ka hyrë në fuqi dhe zbatohet ligji nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, që bashkë me aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, ka ndryshuar rregullat e zbatueshme në fuqi dhe në këto kushte kuadri ligjor i zbatueshëm duhet të zëvendësohet nga AK në DST.*

- **Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK qëndron** sepse ligji nr.9887, datë 10.03.2008 i ndryshuar është shfuqizuar me nenin 99 të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke kërkuar modifikimin e kësaj pike në specifikimet teknike.

Pika 2- *Në specifikimet teknike të publikuara në dokumentin e veçantë bashkëlidhur DST, për ruajtjen e dokumentave tatimore është shënuar afati i gabuar 5 – 10 vjet, ndërkohë që afati sipas nenit 179 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 48, pika 2, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2020, “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar, është vetëm 5 vjet. Vendosja e një afati të paligjshëm për ruajtjen e dokumentacionit në një sistem elektronik taksash vendore i bën specifikimet e DST në kundërshtim me ligjin dhe për pasojë Kreatx SHPK çmon se, afati në këtë rast duhet të zëvendësohet AK në përputhje me afatin që parashikon neni 48 i ligjit për procedurat tatimore.*

- **Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK qëndron** sepse sipas nenit 48 “Mbajtja dhe ruajtja e dokumentave të të dhënave tatimore”, pika 2 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2020, “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar, citohet se: “Të dhënat dhe informacioni financiar e kontabël ruhet nga tatimpaguesi, për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit tatimor, të cilit i përkasin dokumentat.”

Pika 3- Në shtojcën nr.7, AK ka përcaktuar grafikun e shërbimeve dhe të ekzekutimit, që shërben edhe si tabelë orientuese për të depozituar ofertën ekonomike me zërat e shërbimeve për njësi dhe në total nga OE. Kreatx SHPK vëren se kjo tabelë është e pasaktë, pasi nuk kuptohet si janë ndarë zërat e mirëmbajtjes dhe të implementimit në raport me kohëzgjatjen e tyre. Kreatx SHPK e ka të pamundur që të kuptojë nëse kontrata zgjat 12 muaj apo 24 muaj, pasi AK nga njëra anë shprehet në DST se, afati i implementimit është 12 muaj, ndërsa nga ana tjetër citon se afati i mirëmbajtjes së sistemit të ri të implementuar është 12 muaj nga momenti që mbaron implementimi.

- **Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik Kreatx nuk qëndron** sepse:
 - a) Në lidhje me afatin e kryerjes së shërbimit e cila përfshin implementim dhe mirëmbajtje është përcaktuar qartë afati i ekzekutimit 12 muaj.
 - b) Në lidhje me shtojcën 2 “Lista e cmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimeve, është hedhur sipas preventivit të dorëzuar nga grupi i punës për përlllogartijen e fondit limit dhe është sipas formatit të kësaj shtojce.

Pika 4- Sa i takon grafikun të ekzekutimit që AK ka vendosur në DST, Kreatx SHPK vëren se është i paplotë, pasi është përgjysmë dhe përfshin vetëm 5 muajt e parë të ekzekutimit të kontratës, ndonëse shërbimet sipas kontratës presupozohen që të zgjasin për 12 apo 24 muaj. Pra, edhe në këtë drejtim AK duhet të plotësojë saktë DST.

Grafiku i paplotë i ekzekutimit të shërbimeve që ka vendosur AK paraqitet si më poshtë: Shërbimet që kërkohen: 12 muaj

Afatet e ekzekutimit: 12 MUAJ

Faza	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5
Analiza & Blueprint	1	1	0	0	0
Zhvillimi Moduleve Bazë	0	1	1	1	0
Infrastruktura & Siguria	0	1	0	0	0
Integrimet	0	0	1	1	0
Migrimi i të Dhënave	0	0	1	0	0
Testimi	0	0	1	0	0
Trajnimet	0	0	0	1	0
Go-Live & Cutover	0	0	0	1	0
Hypercare	0	0	0	1	1

Përveç sa më lart, Kreatx SHPK vëren se, mes formularit të ofertës ekonomike dhe grafikun të ekzekutimit ka dallime sa i përket zërave të shërbimit që duhet të përmbushen nga kontraktori. Këto dallime janë të atij lloji që, i pamundësojnë OE ofertues të paraqesin një ofertë ekonomike në përputhje me LPP dhe RRPP dhe i pamundësojnë OE ofertues që të përlllogarisin saktë

vlerën e ofertës ekonomike drejtuar AK. Këto mospërputhje dhe konfuzione mes grafikut të ekzekutimit dhe formularit të ofertës ekonomike dhe pasaktësitë e rënda në drejtim të zërave të ndryshëm të shërbimeve, shërbejnë si shkak që AK të rregullojë DST vetëm përmes anulimit të kësaj procedure prokurimi publik, sipas nenit 98, pika 1, shkronja “c”, të LPP, duke ngarkuar në SPE DST të reja dhe duke shpallur një prokurim të ri.

- **Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik Kreatx qëndron** sepse në grafikun e ekzekutimit nuk janë përfshirë të 12 muajt si dhe përcaktimi i saktë i secilit zë preventivi sipas afatit të tyre të ekzekutimit, duke ndikuar në formulimin e ofertës ekonomike nga operatorët pjesëmarrës, duke kërkuar modifikimin e grafikut për të 12 muajt.

Faza	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5	Muaji 6	Muaji 7	Muaji 8	Muaji 9	Muaji 10	Muaji 11	Muaji 12
Analiza & Blueprint			0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Zhvillimi Moduleve Bazë	0				0	0	0	0	0	0	0	0
Infrastruktura & Siguria	0		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Integrimet	0	0			0	0	0	0	0	0	0	0
Migrimi i të Dhënave	0	0		0	0	0	0	0	0	0	0	0
Testimi	0	0		0	0	0	0	0	0	0	0	0
Trajnimet	0	0	0									
Vendosje Online	0	0	0		0	0	0	0	0	0	0	0
Mirembajtje	0	0	0									

Pika 5- Në shtojcën nr.9, pika 2, të DST, për numrin e punonjësve, AK përcakton se, operatori ekonomik duhet të disponojë një punësim mesatar të paktën 7 (pesëmbëdhjetë) punonjës të punësuar, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me: Kreatx SHPK konstaton se, kërkesa e posaçme për numrin e punonjësve është e paqartë, pasi nuk kuptohet nëse bëhet fjalë për 7 apo 15 punonjës. Nëse bëhet fjalë për 15 punonjës, ky numër është i paargumentuar në DST, pasi AK nuk jep shpjegime mjaftueshëm për një kërkesë kaq të lartë punonjësish në raport me vlerën e prokurimit, nevojat e prokurimit dhe të AK, si dhe praktikën administrative të prokurimit publik në përgjithësi në Shqipëri. Për pasojë, kjo kërkesë e posaçme duhet të rregullohet nga AK, duke ulur numrin e punonjësve nga 15 që është përcaktuar dhe duke anuluar procedurën e prokurimit dhe duke zhvilluar një procedurë të re prokurimi nga e para.

- **Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik Kreatx nuk qëndron** sepse sipas koordinimit të APP-së dt.27.02.2026 dhe nenit 75 të LPP-së janë bërë ndryshimet përkatëse të dokumentave të tenderit.

Pika 6- Për kërkesat e vendosura në shtojcën nr.9, në lidhje me ISO, AK përcakton se, OE ofertues duhet të zotërojë midis të tjerave ISO 42001:2023 dhe ISO 22301:2019. Kreatx SHPK vëren se, ISO 42001:2023 është një ISO që certifikon subjektet tregtare për menaxhimin e inteligjencës artificiale, ndërsa ISO 22301:2019 është një ISO që certifikon subjektet tregtare për planet e menaxhimit të biznesit. Kreatx SHPK vëren se, vendosja e këtyre dy ISO-ve nga ana e AK është e pajustificuar dhe e paargumentuar nga AK për arsyet e mëposhtme:

1. Për ISO 42001:2023, në Republikën e Shqipërisë nuk ka asnjë subjekt tregtar të certifikuar për menaxhimin e inteligjencës artificiale. Për këtë mund të shikoni edhe faqen e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit dhe atë të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, që nuk kanë asnjë subjekt tregtar të certifikuar për këto ISO. Madje as nuk e njohin aspak një ISO të tillë.

2. Për më tepër, nga informacioni që disponon Kreatx SHPK, nuk rezulton të jetë ketë asnjë subjekt privat apo shtetëror të akredituar nga DPA në vendin tonë, që të inspektojë apo lëshojë certifikatë të tillë ISO. Duke mos u gjendur një certifikatë e tillë në tregun tonë të brendshëm, kuptohet që kërkesa e vendosur nga AK është e paligjshme, jokoherente në raport me situatën faktike duhet hequr nga DST.

3. Gjithashtu, nga përmbajtja e specifikimeve teknike të DST, AK e justifikon përdorimin e AI me faktin e përlllogaritjes së taksave vendore, me parashikimet për mbledhjen e tyre, me përgatitjen e dokumentave të kontrollit e të inspektimit të njësisë së taksave vendore pranë Bashkisë Vlorë, etj., veprime këto që janë të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar dhe në vendimet e Këshillit Bashkiak Vlorë, për të cilat nuk nevojitet përdorimi i AI, për sa kohë që i përcakton legjislacioni i zbatueshëm në fuqi mjaft mirë.

4. Në kushtet kur AI është thjesht një mjet ndihmës dhe nevojat që AK e justifikojnë përdorimin e AI për shërbime që janë të mirëpërcaktuara me ligj dhe akte nënligjore, vendosja e një ISO kaq të posaçme, thjesht kufizon konkurrencën për OE ofertues qëllimisht. Pra, jemi përpara një kufizimi të paligjshëm e të dëmshëm e me keqdashësi të konkurrencës në prokurimin publik.

5. Ndërkohë, ISO 22301:2019, nënkupton që OE ofertues të ketë planin e vazhdimin të biznesit në rast incidenti dhe si e tillë është një certifikim që nuk nevojitet për këtë prokurim publik, për sa kohë që me VKM nr.813, datë 30.12.2025, janë miratuar masat teknike, operacionale dhe organizative të operatorëve që disponojnë infrastruktura kritike dhe të rëndësishme. Sipas VKM nr.813/2025, çdo autoritet publik apo privat tashmë me stadardet e reja të sigurisë kibernetike, ka detyrimin ligjor që të respektojë dhe zbatojë këto masa, duke përfshirë ndër të tjera edhe një plan për vazhdimin e biznesit dhe një plan për Disaster Recovery. Për rrjedhojë, vendosja e ISO 22301:2019 si një standard i posaçëm për ofertuesit, bie ndesh me kuadrin ligjor në fuqi, që i detyron operatorët ekonomikë ofertues t`a kenë një BCP në rastet kur implementojnë dhe mirëmbajnë sisteme të infrastrukturës të rëndësishme ose kritike.

6. Pra, për sa kohë që BCP është tashmë detyrim ligjor për subjektet tregtare në fushën e TIK dhe përbën një situatë të zakonshme, AK nuk mund t`a përdorë ISO 22301:2019 si standard kualifikues/skualifikues për ofertuesit gjatë prokurimit publik.

➤ **Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik Kreatx nuk qëndron sepse**

Autoriteti Kontraktor ka vendosur kërkesën që Operatori Ekonomik ofertues të zotërojë ISO 42001:2023 dhe ISO 22301:2019. si standarde ndërkombëtare të menaxhimit, për të garantuar realizimin me cilësi, siguri dhe qëndrueshmëri të shërbimeve në funksion të interesit publik dhe të punës së Bashkisë.

1. ISO 42001:2023 — Menaxhimi i Sistemeve të Inteligjencës Artificiale

ISO 42001:2023 është standardi i parë ndërkombëtar për sistemet e menaxhimit të inteligjencës artificiale. Ai siguron që përdorimi i AI të jetë i kontrolluar dhe i dokumentuar,

të garantojë transparencë dhe gjurmueshmëri të proceseve, të menaxhojë rreziqet që lidhen me automatizimin dhe xendimmarrjen dhe të respektojë parimet e etikës, sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

Perdorimi i AI ne sistemi e taksave dhe tarifave Vendore do te bej llogaritje me te sakte dhe te detajuar te cdo lloj takse, gjobe , etj pasi Inteligjences Artificiale nuk perben zgjedhje selektive ne asnje lloj aspekti , hjo gje ndihon ndjeshem tek buxheti I shtetit.

Në kushtet kur projekti përfshin përdorimin e teknologjive digjitale dhe elementëve të AI në përpunimin e të dhënave apo optimizimin e proceseve administrative, kërkesa për këtë standard sjnon të minimizojë rreziqet ligjore dhe operacionale ,të garantojë integritetin e të dhënave publike. të sigurojë që sistemi të funksionojë në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare.

Kjo kërkesë nuk vendoset për të kufizuar konkurrencën, por për të siguruar që operatori ekonomik të ketë kapacitete të strukturuar dhe të audituara për menaxhimin e AI .

2. ISO 22301:2019 — Sistemi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit (BCMS)

ISO 22301:2019 është standard ndërkombëtar për menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit (Business Continuity Management System — BCMS)

Ky standard garanton që operatori ekonomik ka një plan të Vazhdimësisë së Biznesit (BCP) , ka plane të dokumentuara për Disaster Recovery, është i përgatitur për situata emergjente (sulme kibernetike, ndërprerje sistemesh, fatkeqësi natyrore etj.) dhe siguron vazhdimësinë e shërbimeve publike pa ndërprerje.

Shërbimet qëlidhen me administratën vendore, sistemet e të dhënave dhe infrastrukturën digjitale nuk mund të ndërpriten, pasi prekin drejtpërdrejtë interesin publik dhe funksionimin e Bashkisë. Për këtë arsye, kërkesa për ISO 22301:2019 synon të mbrojëinteretin publik, të sigurojë vazhdimësinë e shërbimeve ndaj qytetarim reduktojë riskun financiar dhe operacional për institucionin.

Përputhshmëria me parimet e prokurimit publik dhe Vendorsja e këtyre standardeve lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontrates , eshte proporcionale me rendesine dhe kompleksitetin e sherbimit , garanton cilësi, siguri dhe qëndrueshmeri afatgjatë, mbështetet në standarde ndërkombëtare të njohura globalisht.

Qëllimi i Autoritetit kontraktor nuk është kufizimi i konkurrencës, por garantimi që operatorët ekonomike të disponojnë sisteme të certifikuara menaxhimi që sigurojnë performancë të qëndrueshme, menaxhim risku dlie mbrojtje të interesit publik.

Pika 7- Në shtojcën nr.9 të DST, AK ka vendosur si kërkesa të posaçme certifikimet e punonjësve si më poshtë:

1. OE duhet të këtë 1 zhvillues senior në teknologjinë Net ose ekuivalent me të paktën 3-5 vite ekperiencë.
2. OE duhet të këtë 1 zhvillues senior në teknologjinë Oracle Database Administrator ose ekuivalent me të paktën 3-5 vite ekperiencë.
3. Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent.
4. Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert Database Administrator në Oracle dhe të certifikuar për Oracle Database 11g: SQL

Fundamentals I (1Z0-051), Oracle Database Security Audit dhe Omega Core Audit.

5. *Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert Backend Developer i certifikuar nga Google Cloud.*

6. *Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se ka në marrëdhënie bashkëpunimi të paktën një Ekspert në Sigurimin e Cilësisë së Softuerit (QA).*

7. *Ekspert në menaxhimin e projekteve (Ky nuk është vendosur fare tek certifikimet, por tek pjesa e argumentimit të vendosur në DST).*

Kreatx SHPK vëren se për certifikimet me nr.1 dhe nr.2, kërkohet përvojë nga 3 deri në 5 vjet dhe mënyra e hartimit të kërkesës së posaçme është krejtësisht konfuze dhe e paqartë, edhe po të shohësh procesverbalin e argumentimit. Pra, në titullin e certifikimit të posaçëm AK ka caktuar përvojën prej 3 vjet, ndërsa në pjesën argumentuese të tij, certifikimi shënohet me përvojën 5 vjet. Këto paqartësi të dukshme përbëjnë shkelje të rënda të neneve 41 të LPP dhe 36 të RRPP, sipas të cilëve kërkesat e vendosura në DST duhet të jenë të qarta për ofertuesit, në përputhje me nevojat e AK, me qëllim që OE të ketë mundësinë të paraqesë ofertën ekonomike sipas LPP.

Në shtesë të argumentave më lart, vendosja e përvojës për punonjësit e certifikuar është paksa kontradiktore, pasi AK nuk e mat dot përvojën mbi bazë certifikimi, por vetëm mbi bazë vjetërsie pune. Kjo pasi, ka punonjës që mund të jenë certifikuar, por nuk kanë ushtruar veprimtari për 3 apo 5 vjet me radhë për veprimtarinë që janë certifikuar. Pra, në praktikë, mbetet faktikisht e paprovuar nëse punonjësi ka përvojë 3 apo 5 vite për një certifikim të posaçëm. Nga ana tjetër, po një punonjës që ka 10 vjet që është certifikuar, e përmbush apo jo kërkesën e posaçme, n kushtet kur kërkon 3 – 5 vite përvojë për certifikim ? Një kufizim me 3 – 5 vjet përvojë për certifikim, është i pajustificuar në raport me nevojat e prokurimit, i pajustificuar në raport me nevojat e AK, si dhe me vetë përcaktimet e LPP dhe RRPP. Theksojmë se, sipas KPP, certifikimet vendosen nga ana e AK për OE ofertues, me qëllim që AK të kuptojë nëse OE i ka apo jo kapacitetet për të përmbushur detyrimet kontraktore, e jo për të kufizuar në mënyrë abuzive konkurrencën në prokurimin publik siç ka vepruar Bashkia Vlorë në këtë rast.

Pra, AK duhet të ndryshojë DST dhe të heqë përvojën për certifikimet me nr.1 dhe nr.2 sipas argumentit të paraqitur në këtë ankim administrativ.

Përsa i përket kërkesës së posaçme për ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent, Kreatx SHPK vlerëson se ajo është hartuar gabim, pasi me një kërkesë të posaçme janë vendosur dy certifikime të ndryshme. AK duhet të kishte ndarë certifikimet CISO dhe CISA nga njëra-tjetra, për sa kohë që janë të ndryshme ose duhet të kishte shprehur për natyrën alternative të tyre, me qëllim që OE ofertues të kuptonin që plotësimi i njërit prej tyre e bënte ofertën e ekonomike të kualifikueshme në raport me këtë kërkesë.

Përsa i përket kërkesës së posaçme për ekspert Database Administrator në Oracle dhe të certifikuar për Oracle Database 11g: SQL Fundamentals I (1Z0-051), Oracle Database Security Audit dhe Omega Core Audit, Kreatx SHPK vëren se kjo kërkesë e posaçme, nuk është e qartë, pasi nga mënyra sesi është shkruar në DST nuk kuptohet nëse kërkohen punonjës me certifikime alternative apo kumulative. Pra, nëse ofertuesi duhet të depozitohet dokumentacion për punonjës edhe si Oracle Database Security edhe si Oracle Database SQL edhe për Omega

Core Audit apo mjafton që ofertuesi të paraqesë dokumentacion vetëm për një të njërin prej tyre, me qëllim që të përmbushet kërkesa e posaçme në DST.

Po kështu, AK nuk argumenton nevojën e tre certifikimeve të ndryshme, e madje nuk shpjegon as ekuivalencën mes tyre. Theksojmë se, nëse databaza e sistemit të taksave vendore pranë Bashkisë Vlorë do të jetë Oracle, nuk ka nevojë për sistem Omega Core Audit. Vendosija e katër certifikimeve të ndryshme në një kërkesë të posaçme, që duhen ndarë sipas LPP, sjell konfuzion dhe paqartësi për OE të cilët e kanë të pamundur për të ofertuar sipas LPP dhe RRPP. Kërkesa e certifikimit të trefishtë nuk justifikohet as në procesverbalin e argumentimit nga AK, e prandaj duhen rregulluar edhe një herë nga e para DST, duke anuluar këtë procedurë prokurimi dhe duke shpallur një të re në SPE.

Përsa i përket kërkesës së posaçme për ekspert Backend Developer të certifikuar nga Google Cloud, Kreatx SHPK vëren se kërkesa është abuzive, pasi AK ka vendosur një certifikim të dedikuar nga Google pa përdorur termin ekuivalent siç e kërkon neni 36 i RRPP. Po ashtu, kërkesa është e pajustificuar për nevojat e prokurimit publik, pasi certifikimet back-end janë të llojeve të ndryshme në tregun e lirë dhe nuk ka përse të jenë të dedikuar vetëm për Google, pasi AK nuk paraqet asnjë nevojë për shërbime nga Google. Duke qenë një certifikim i pajustificuar as në procesverbal dhe as nga nevojat e prokurimit publik, dallohet qartë se kërkesa e posaçme është vendosur nga AK në kundërshtim me LPP, me qëllimin e vetëm të kufizimit të OE ofertues për të marrë pjesë në prokurimin publik.

Sa i përket kërkesës së posaçme për ekspert në sigurimin e cilësisë së softuerit (QA), Kreatx SHPK vëren se nuk është argumentuar nevoja e një kërkesë të këtillë të tillë në procesverbalin e argumentimit nga AK. Për pasojë, mbajtja e një kërkesë të tillë në DST duhet të argumentohet nga AK ose në të kundërt duhet të hiqet prej tyre.

Në lidhje me kërkesën e posaçme për ekspert në menaxhimin e projekteve, Kreatx SHPK konstaton se kjo kërkesë nuk është vendosur tek certifikimet, por vetëm tek pjesa e argumentimit të tyre në DST. Prandaj, AK duhet të rregullojë DST edhe sa i takon kësaj kërkesë të posaçme, me qëllim që DST të jenë transparente në raport me OE ofertues që kanë dëshirë të marrin pjesë në tender.

Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik Kreatx qëndron duke kërkuar ndryshimin e këtij kriteri konkretisht:

2.5 *Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar të diplomuar në një nga degët e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion, me kompetencat minimalisht si më poshtë:*

1. Zhvillues Senior në teknologjinë .NET (minimumi 3 vite eksperiencë) ose ekuivalente

Teknologjia .NET përdoret për ndërtimin e logjikës së biznesit dhe arkitekturës së sistemit. Eksperienca minimale 5-vjeçare garanton: Projektim arkitekturor të qëndrueshëm; Zhvillim të sigurt dhe të optimizuar; Mirëmbajtje dhe shkallëzim afatgjatë të sistemit. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me realizimin korrekt të sistemit dhe proporcional me kompleksitetin e tij.

2. Administrator i Bazës së të Dhënave – Oracle (minimumi 3 vite eksperiencë) ose ekuivalente

Sistemi përpunon volume të konsiderueshme të dhënash financiare dhe tatimore. Ekspertiza në Oracle Database garanton: Integritet të të dhënave; bPerformancë të optimizuar; Siguri dhe mekanizma rikuperimi (backup & recovery); Auditueshmëri të transaksioneve financiare.

3. Ekspert auditues i certifikuar (CISA, CISO ose ekuivalent) ose ekuivalente

Certifikimi si CISA ose ekspertizë në nivel CISO siguron: Auditueshmëri të proceseve; Kontroll të brendshëm IT; Vlerësim të rreziqeve teknologjike; Përputhshmëri me standarde ndërkombëtare të kontrollit dhe sigurisë. Në një sistem fiskal, gjurmueshmëria dhe kontrolli janë elementë thelbësorë.

4. Ekspert Oracle i certifikuar (SQL Fundamentals, Security Audit) ose ekuivalente

Certifikimet specifike në Oracle dëshmojnë: Njohuri të thelluara në menaxhimin e bazave të të dhënave; Implementim të sigurt të strukturës së të dhënave; Audit të brendshëm të konfigurimeve të sigurisë. Kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e të dhënave tatimore.

5. Ekspert në Menaxhimin e Projekteve ose ekuivalente

Projekti kërkon: Planifikim të detajuar; Menaxhim të riskut; Koordinim të ekipeve multidisiplinare; Respektim të afateve dhe buxhetit.

6. Ekspert në Sigurinë Kibernetike ose ekuivalente

Sistemi i taksave është objekt me risk të lartë për sulme kibernetike. Eksperti garanton: Analizë të cenueshmërisë; Testim penetrimi; Hardening të infrastrukturës; Monitorim të vazhdueshëm të sigurisë.

7. Ekspert në Sigurimin e Cilësisë (QA) ose ekuivalente

Për shkak të ndikimit financiar të sistemit, çdo gabim funksional mund të shkaktojë pasoja ekonomike dhe ligjore. Eksperti QA siguron: Testim funksional; Testim performance; Testim sigurie; Verifikim përputhshmërie me kërkesat teknike.

Pika 8- : Në shtojcën nr.9 të DST, AK ka përcaktuar se: “Për personeli nevojitet dorëzimi i këtyre dokumentave (...) Certifikata/Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar; Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B; Kontratë punë.; Cv; Kontratat e bashkëpunimit.”.

Kreatx SHPK çmon se, dokumentacioni i kërkuar për stafin është shkruar në mënyrë të paqartë për sa i përket kontratave të bashkëpunimit. Kjo pasi, sipas LPP dhe RRPP, OE ofertues që duan të marrin pjesë në tender kanë mundësi që të depozitojnë një ofertë ekonomike të vlefshme sa i takon stafit dhe personelit teknik në këto forma:

4. Duke disponuar punonjës me kontrata pune si punonjës të tyre;
5. Duke u bashkuar me një operator tjetër ekonomik ofertues për të siguar stafin e nevojshëm të certifikuar në mënyrë të plotë si BOE;
6. Duke u mbështetur tek kapacitetet e një operatori tjetër ekonomik, pa kaluar 50 % të detyrimeve kontraktore, që në masën mbi 50% të tyre duhet të përmbushen nga ofertuesi.

Duke ju referuar tre mënyrave të ofertimit siç përcaktojnë LPP dhe RRPP më lart, vendosja e një kërkesë të posaçme për të dëshmuar stafin e nevojshëm me kontrata bashkëpunimi, lë hapësira për abuzivitet nga OE ofertues, pasi ata mund të kontraktjnë staf të certifikuar sipas kërkesave të vendosura në DST me çdolloj personi, edhe nëse ky nuk rezulton si subjekt tregtar në qarkullimin civil sipas ligjit organik për tregtarët dhe shoqërinë tregtare. Kjo sjellje mund të bjerë në kundërshtim me legjislacionin e punës dhe rekomandimet e Inspektoratit të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, që nuk i legjitimon kontratat e bashkëpunimi me persona fizikë të papajisur me NUIS sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Vendosja e kontratave të bashkëpunimit kaq gjerë lë hapësirë për ofertime nga OE që shkelin legjislacionin e punës, me persona fizikë që nuk shlyejnë detyrimet e taksave, tatimeve dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Po ashtu, kjo mund të bëhet shkak që gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, AK të ndeshet me ofertues që nuk janë të pavarur, pasi i njëjti person fizik mund të kontraktohet me bashkëpunim për efekt të certifikimit të tij nga disa OE ofertues në tender.

Për rrjedhojë, AK duhet të sqarojë se në DST se do të pranohen të vlefshme vetëm ofertues kontrata bashkëpunimi të lidhura me persona fizikë tregtarë dhe jo çfarëdolloj personi fizik. Së fundi; Në dokumentacionin e specifikimeve teknike bashkëngjitur DST, AK citon se, sistemi i taksave vendore të Bashkisë Vlorë do të përdorë AI për arsyet e mëposhtme: “XI. Integrimi i një moduli të inteligjencës artificiale në Sistemin e ri të Taksave dhe Tarifave vendore të Bashkisë Vlorë. (..) Ky modul do të automatizojë procese kyçe si: Identifikimi i subjekteve tatimpaguese dhe verifikimi i të dhënave të tyre duke përdorur algoritme analitike. Parashikimi i të ardhurave, bazuar në të dhënat historike dhe modelet e konsumit apo veprimtarisë ekonomike. Zbulimi i rasteve anormale si mospërputhje, evazion potencial ose gabime në deklarime. Asistimi i qytetarëve përmes një asistenti inteligjent që ofron informacion në kohë reale, udhëzime dhe përgjigje automatike. Optimizimi i vendimmarrjes së administratës duke gjeneruar raporte të personalizuar dhe rekomandime. Përfitimet kryesore përfshijnë: Rritje të saktësisë në administrimin e të dhënave. Ulje të kostove operative dhe kohës së përpunimit. Rritje të besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve. Automatizim të proceseve të

përsëritura dhe reduktim të gabimeve njerëzore. Në thelb, integrimi i AI ndihmon Bashkinë Vlorë të ndërtojë një sistem taksash dhe tarifash më të zgjuar, më efikas dhe më të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarëve.”

Nisur nga argumentimi për implementimin e AI në sistemin e taksave vendore Vlorë, Kreatx SHPK konstaton se, AI shërben si një mekanizëm lehtësues i punëve të përditshme, por AI nuk identifikon subjektet tatimpaguese, pasi kjo është detyrë e inspektorëve të taksave vendore në Bashkinë Vlorë. Po ashtu, AI nuk mund të parashikojë të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe as të zbulojë evazion fiskal apo gabimet në deklarimet tatimore, procedura këto që janë të mirëpërcaktuara në ligj. Për pasojë, implementimi i AI duhet të jetë plotësisht i argumentuar në DST nga AK.”.

Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik Kreatx qëndron, duke kërkuar ndryshime të këtij kriteri konkretisht:

2.5 *Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar të diplomuar në një nga degët e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion, me kompetencat minimalisht si më poshtë:*

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- *Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;*
- *Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B; me kontrate Bashkëpunimi*
- *Kontratë punë.*
- *Cv*
- *Kontratat e bashkëpunimit*

Në përmbyllje vlerësojmë se pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik Kreatx SHPK ptanohen për pikat 1,2,6,7 dhe pika 8 të ankesës dhe rrëzohet për pikën 3 dhe pikën 5 të kriterëve të vendosura nga Njësia e Prokurimit.”

III

Komisioni i Prokurimit Publik

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit e dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Kreatx” SHPK, të parashtruara në pikën 1, 2, 3, 4,7,8 dhe të fundit të ankesës se:

“Së pari: Në specifikimet teknike që janë publikuar në dokumentin e veçantë bashkëlidhur DST nga AK, referohet për zbatim legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale. Kreatx SHPK konstaton se referohet për zbatim ligji nr.9887, datë 10.03.2008, ndërkohë që prej vitit 2024 ka hyrë në fuqi ligji nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Për pasojë, Kreatx SHPK vlerëson se, të gjitha kërkesat e posaçme të vendosura nga AK për mbrojtjen e të dhënave personale janë të paligjshme, sepse janë mbështetur në ligjin e shfuqizuar dhe në protokollin e vjetër për mbrojtjen e tyre. Aktualisht, ka hyrë në fuqi dhe zbatohet ligji nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, që bashkë me aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, ka ndryshuar rregullat e zbatueshme në fuqi dhe në këto kushte kuadri ligjor i zbatueshëm duhet të zëvendësohet nga AK në DST.

Së dyti: Në specifikimet teknike të publikuara në dokumentin e veçantë bashkëlidhur DST, për ruajtjen e dokumentave tatimore është shënuar afati i gabuar 5 – 10 vjet, ndërkohë që afati sipas nenit 179 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 48, pika 2, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2020, “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar, është vetëm 5 vjet. Vendosja e një afati të paligjshëm për ruajtjen e dokumentacionit në një sistem elektronik taksash vendore i bën specifikimet e DST në kundërshtim me ligjin dhe për pasojë Kreatx SHPK çmon se, afati në këtë rast duhet të zëvendësohet AK në përpunje me afatin që parashikon neni 48 i ligjit për procedurat tatimore.

Së treti: Në shtojcën nr.7, AK ka përcaktuar grafikun e shërbimeve dhe të ekzekutimit, që shërben edhe si tabelë orientuese për të depozituar ofertën ekonomike me zërat e shërbimeve për njësi dhe në total nga OE. Kreatx SHPK vëren se kjo tabelë është e pasaktë, pasi nuk kuptohet si janë ndarë zërat e mirëmbajtjes dhe të implementimit në raport me kohëzgjatjen e tyre. Kreatx SHPK e ka të pamundur që të kuptojë nëse kontrata zgjat 12 muaj apo 24 muaj, pasi AK nga njëra anë shprehet në DST se, afati i implementimit është 12 muaj, ndërsa nga ana tjetër citon se afati i mirëmbajtjes së sistemit të ri të implementuar është 12 muaj nga momenti që mbaron implementimi.

Ndërkohë, tabela e ofertimit është gjithashtu e paplotë, sepse nuk përmban afatin 12 mujor për implementimin siç kërkohet në përmbytje të specifikimeve teknike bashkëlidhur DST. Kreatx SHPK thekson se, kjo paqartësi është thelbësore për ecurinë e zbatimit të kontratës dhe pamundëson mbarëvajtjen e prokurimit publik, duke sjellë si pasojë anulimin e tenderit, sipas nenit 98, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar. Tabela e grafikut të shërbimeve, të ekzekutimeve dhe të ofertimeve që ka vendosur AK paraqitet si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i Shërbimit	Vlera e Parashikuar Pa TVSH (ALL)
1.	Implementimin e Sistemit të ri të Taksave dhe Tarifave Vendore	

2.	Analizë dhe Migrim i të dhënave historike nga Microsoft Navision R2 në Sistemit të ri te Taksave dhe Tarifave Vendore	
3.	Testim, trajnime të stafit dhe dokumentacion	
4	Shërbim të dedikuar Cloud + Backup	
5	Mirëmbajtje dhe Mbështetje pas implementimit (12 muaj)	
	TOTALI pa TVSH	
	TVSH 20%	
	TOTALI pa TVSH	

Paqartësia e mësipërme për afatin e zbatimit të kontratës për një periudhë prej 12 muajsh, shoqërohet edhe me një problematikë tjetër në tabelën e ofertimit në DST, ku të dyja vlerat e shënuara brenda saj janë pa TVSH, ndonëse sipas LPP dhe RRPP vlerat e ofertës duhet të paraqiten në tabelë pa TVSH dhe me TVSH. Si rezultat, AK duhet të rregullojë edhe tabelën e ofertimit.

Së katërti: Sa i takon grafikut të ekzekutimit që AK ka vendosur në DST, Kreatx SHPK vëren se është i paplotë, pasi është përgjysmë dhe përfshin vetëm 5 muajt e parë të ekzekutimit të kontratës, ndonëse shërbimet sipas kontratës presupozohen që të zgjasin për 12 apo 24 muaj. Pra, edhe në këtë drejtim AK duhet të plotësojë saktë DST.

Grafiku i paplotë i ekzekutimit të shërbimeve që ka vendosur AK paraqitet si më poshtë: Shërbimet që kërkohen: 12 muaj

Afatet e ekzekutimit: 12 MUAJ

Faza	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5
Analiza & Blueprint	1	1	0	0	0
Zhvillimi Moduleve Bazë	0	1	1	1	0
Infrastruktura & Siguria	0	1	0	0	0
Integrimet	0	0	1	1	0
Migrimi i të Dhënave	0	0	1	0	0
Testimi	0	0	1	0	0
Trajnimet	0	0	0	1	0
Go-Live & Cutover	0	0	0	1	0
Hypercare	0	0	0	1	1

Përveç sa më lart, Kreatx SHPK vëren se, mes formularit të ofertës ekonomike dhe grafikut të ekzekutimit ka dallime sa i përket zërave të shërbimit që duhet të përmbushen nga kontraktori. Këto dallime janë të atij lloji që, i pamundësojnë OE ofertues të paraqesin një ofertë ekonomike në përputhje me LPP dhe RRPP dhe i pamundësojnë OE ofertues që të përlllogarisin saktë vlerën e ofertës ekonomike drejtuar AK. Këto mospërputhje dhe konfuzione mes grafikut të ekzekutimit dhe formularit të ofertës ekonomike dhe pasaktësitë e rënda në drejtim të zërave të ndryshëm të shërbimeve, shërbejnë si shkak që AK të rregullojë DST vetëm përmes anulimit të kësaj procedure prokurimi publik, sipas nenit 98, pika 1, shkronja “c”, të LPP, duke ngarkuar në SPE DST të reja dhe duke shpallur një prokurim të ri.

Së pesti: Në shtojcën nr.9, pika 2, të DST, për numrin e punonjësve, AK përcakton se, operatori ekonomik duhet të disponojë një punësim mesatar të paktën 7 (pesëmbëdhjetë) punonjës të

punësuar, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me:

Kreatx SHPK konstaton se, kërkesa e posaçme për numrin e punonjësve është e paqartë, pasi nuk kuptohet nëse bëhet fjalë për 7 apo 15 punonjës. Nëse bëhet fjalë për 15 punonjës, ky numër është i paargumentuar në DST, pasi AK nuk jep shpjegime mjaftueshëm për një kërkesë kaq të lartë punonjësish në raport me vlerën e prokurimit, nevojat e prokurimit dhe të AK, si dhe praktikën administrative të prokurimit publik në përgjithësi në Shqipëri. Për pasojë, kjo kërkesë e posaçme duhet të rregullohet nga AK, duke ulur numtin e punonjësve nga 15 që është përcaktuar dhe duke anuluar procedurën e prokurimit dhe duke zhvilluar një procedurë të re prokurimi nga e para.”,

Së shtati: *Në shtojcën nr.9 të DST, AK ka vendosur si kërkesa të posaçme certifikimet e punonjësve si më poshtë:*

- 1. OE duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë Net ose ekuivalent me të paktën 3-5 vite ekperiencë.*
- 2. OE duhet të ketë 1 zhvillues senior në teknologjinë Oracle Database Administrator ose ekuivalent me të paktën 3-5 vite ekperiencë.*
- 3. Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent.*
- 4. Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert Database Administrator në Oracle dhe të certifikuar për Oracle Database 11g: SQL Fundamentals I (1Z0-051), Oracle Database Security Audit dhe Omega Core Audit.*
- 5. Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert Backend Developer i certifikuar nga Google Cloud.*
- 6. Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se ka në marrëdhënie bashkëpunimi të paktën një Ekspert në Sigurimin e Cilësisë së Softuerit (QA).*
- 7. Ekspert në menaxhimin e projekteve (Ky nuk është vendosur fare tek certifikimet, por tek pjesa e argumentimit të vendosur në DST).*

Kreatx SHPK vëren se për certifikimet me nr.1 dhe nr.2, kërkohet përvojë nga 3 deri në 5 vjet dhe mënyra e hartimit të kërkesës së posaçme është krejtësisht konfuzë dhe e paqartë, edhe po të shohësh procesverbalin e argumentimit. Pra, në titullin e certifikimit të posaçëm AK ka caktuar përvojën prej 3 vjet, ndërsa në pjesën argumentuese të tij, certifikimi shënohet me përvojën 5 vjet. Këto paqartësi të dukshme përbëjnë shkelje të rënda të neneve 41 të LPP dhe 36 të RRPP, sipas të cilëve kërkesat e vendosura në DST duhet të jenë të qarta për ofertuesit, në përputhje me nevojat e AK, me qëllim që OE të ketë mundësinë të paraqesë ofertën ekonomike sipas LPP.

Në shtesë të argumentave më lart, vendosja e përvojës për punonjësit e certifikuar është paksa kontradiktore, pasi AK nuk e mat dot përvojën mbi bazë certifikimi, por vetëm mbi bazë vjetërsie pune. Kjo pasi, ka punonjës që mund të jenë certifikuar, por nuk kanë ushtruar veprimtari për 3 apo 5 vjet me radhë për veprimtarinë që janë certifikuar. Pra, në praktikë, mbetet faktikisht e paprovuar nëse punonjësi ka përvojë 3 apo 5 vite për një certifikim të posaçëm. Nga ana tjetër, po një punonjës që ka 10 vjet që është certifikuar, e përmbush apo jo kërkesën e posaçme, n kushtet kur kërkon 3 – 5 vite përvojë për certifikim ? Një kufizim me 3

– 5 vjet përvojë për certifikim, është i pajustificuar në raport me nevojat e prokurimit, i pajustificuar në raport me nevojat e AK, si dhe me vetë përcaktimet e LPP dhe RRPP. Theksojmë se, sipas KPP, certifikimet vendosen nga ana e AK për OE ofertues, me qëllim që AK të kuptojë nëse OE i ka apo jo kapacitetet për të përmbushur detyrimet kontraktore, e jo për të kufizuar në mënyrë abuzive konkurrencën në prokurimin publik siç ka vepruar Bashkia Vlorë në këtë rast.

Pra, AK duhet të ndryshojë DST dhe të heqë përvojën për certifikimet me nr.1 dhe nr.2 sipas argumentit të paraqitur në këtë ankim administrativ.

Përsa i përket kërkesës së posaçme për ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent, Kreatx SHPK vlerëson se ajo është hartuar gabim, pasi me një kërkesë të posaçme janë vendosur dy certifikime të ndryshme. AK duhet të kishte ndarë certifikimet CISO dhe CISA nga njëra-tjetra, për sa kohë që janë të ndryshme ose duhet të kishte shprehur për natyrën alternative të tyre, me qëllim që OE ofertues të kuptonin që plotësimi i njërit prej tyre e bënte ofertën e ekonomike të kualifikueshme në raport me këtë kërkesë.

Përsa i përket kërkesës së posaçme për ekspert Database Administrator në Oracle dhe të certifikuar për Oracle Database 11g: SQL Fundamentals I (1Z0-051), Oracle Database Security Audit dhe Omega Core Audit, Kreatx SHPK vëren se kjo kërkesë e posaçme, nuk është e qartë, pasi nga mënyra sesi është shkruar në DST nuk kuptohet nëse kërkohen punonjës me certifikime alternative apo kumulative. Pra, nëse ofertuesi duhet të depozittojë dokumentacion për punonjës edhe si Oracle Database Security edhe si Oracle Database SQL edhe për Omega Core Audit apo mjafton që ofertuesi të paraqesë dokumentacion vetëm për njërin prej tyre, me qëllim që të përmbushet kërkesa e posaçme në DST.

Po kështu, AK nuk argumenton nevojën e tre certifikimeve të ndryshme, e madje nuk shpjegon as ekuivalencën mes tyre. Theksojmë se, nëse databaza e sistemit të taksave vendore pranë Bashkisë Vlorë do të jetë Oracle, nuk ka nevojë për sistem Omega Core Audit. Vendosja e katër certifikimeve të ndryshme në një kërkesë të posaçme, që duhen ndarë sipas LPP, sjell konfuzion dhe paqartësi për OE të cilët e kanë të pamundur për të ofertuar sipas LPP dhe RRPP. Kërkesa e certifikimit të trefishtë nuk justifikohet as në procesverbalin e argumentimit nga AK, e prandaj duhen rregulluar edhe një herë nga e para DST, duke anuluar këtë procedurë prokurimi dhe duke shpallur një të re në SPE.

Përsa i përket kërkesës së posaçme për ekspert Backend Developer të certifikuar nga Google Cloud, Kreatx SHPK vëren se kërkesa është abuzive, pasi AK ka vendosur një certifikim të dedikuar nga Google pa përdorur termin ekuivalent siç e kërkon neni 36 i RRPP. Po ashtu, kërkesa është e pajustificuar për nevojat e prokurimit publik, pasi certifikimet back-end janë të llojeve të ndryshme në tregun e lirë dhe nuk ka përse të jenë të dedikuar vetëm për Google, pasi AK nuk paraqet asnjë nevojë për shërbime nga Google. Duke qenë një certifikim i pajustificuar as në procesverbal dhe as nga nevojat e prokurimit publik, dallohet qartë se kërkesa e posaçme është vendosur nga AK në kundërshtim me LPP, me qëllimin e vetëm të kufizimit të OE ofertues për të marrë pjesë në prokurimin publik.

Sa i përket kërkesës së posaçme për ekspert në sigurimin e cilësisë së softuerit (QA), Kreatx SHPK vëren se nuk është argumentuar nevoja e një kërkesë të këtillë të tillë në procesverbalin e argumentimit nga AK. Për pasojë, mbajtja e një kërkesë të tillë në DST duhet të argumentohet nga AK ose në të kundërt duhet të hiqet prej tyre.

Në lidhje me kërkesën e posaçme për ekspert në menaxhimin e projekteve, Kreatx SHPK konstaton se kjo kërkesë nuk është vendosur tek certifikimet, por vetëm tek pjesa e argumentimit të tyre në DST. Prandaj, AK duhet të rregullojë DST edhe sa i takon kësaj kërkesë të posaçme, me qëllim që DST të jenë transparente në raport me OE ofertues që kanë dëshirë të marrin pjesë në tender.

Së teti: *Në shtojcën nr.9 të DST, AK ka përcaktuar se: “Për personeli nevojitet dorëzimi i këtyre dokumentave (...) Certifikata/Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar; Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B; Kontratë punë.; Cv; Kontratat e bashkëpunimit.”.*

Kreatx SHPK çmon se, dokumentacioni i kërkuar për stafin është shkruar në mënyrë të paqartë për sa i përket kontratave të bashkëpunimit. Kjo pasi, sipas LPP dhe RRPP, OE ofertues që duan të marrin pjesë në tender kanë mundësi që të depozitojnë një ofertë ekonomike të vlefshme sa i takon stafit dhe personelit teknik në këto forma:

- 7. Duke disponuar punonjës me kontrata pune si punonjës të tyre;*
- 8. Duke u bashkuar me një operator tjetër ekonomik ofertues për të siguar stafin e nevojshëm të certifikuar në mënyrë të plotë si BOE;*
- 9. Duke u mbështetur tek kapacitetet e një operatori tjetër ekonomik, pa kaluar 50 % të detyrimeve kontraktore, që në masën mbi 50% të tyre duhet të përmbushen nga ofertuesi.*

Duke ju referuar tre mënyrave të ofertimit siç përcaktojnë LPP dhe RRPP më lart, vendosja e një kërkesë të posaçme për të dëshmuar stafin e nevojshëm me kontrata bashkëpunimi, lë hapësira për abuzivitet nga OE ofertues, pasi ata mund të kontraktojnë staf të certifikuar sipas kërkesave të vendosura në DST me çdolloj personi, edhe nëse ky nuk rezulton si subjekt tregtar në qarkullimin civil sipas ligjit organik për tregtarët dhe shoqërinë tregtare. Kjo sjellje mund të bjerë në kundërshtim me legjislacionin e punës dhe rekomandimet e Inspektoratit të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, që nuk i legjitimon kontratat e bashkëpunimi me persona fizikë të papajisur me NUIS sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Vendosja e kontratave të bashkëpunimit kaq gjerë lë hapësirë për ofertime nga OE që shkelin legjislacionin e punës, me persona fizikë që nuk shlyejnë detyrimet e taksave, tatimeve dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Po ashtu, kjo mund të bëhet shkak që gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, AK të ndeshet me ofertues që nuk janë të pavarur, pasi i njëjti person fizik mund të kontraktohet me bashkëpunim për efekt të certifikimit të tij nga disa OE ofertues në tender.

Për rrjedhojë, AK duhet të sqarojë se në DST se do të pranohen të vlefshme vetëm ofertues kontrata bashkëpunimi të lidhura me persona fizikë tregtarë dhe jo çfarëdolloj personi fizik.

Së fundi; Në dokumentacionin e specifikimeve teknike bashkëngjitur DST, AK citon se, sistemi i taksave vendore të Bashkisë Vlorë do të përdorë AI për arsyt e mëposhtme: “XI. Integrimi i një moduli të inteligjencës artificiale në Sistemin e ri të Taksave dhe Tarifave vendore të Bashkisë Vlorë. (..) Ky modul do të automatizojë procese kyçe si: Identifikimi i subjekteve tatimpaguese dhe verifikimi i të dhënave të tyre duke përdorur algoritme analitike. Parashikimi i të ardhurave, bazuar në të dhënat historike dhe modelet e konsumit apo veprimtarisë ekonomike. Zbulimi i rasteve anormale si mospërputhje, evazion potencial ose gabime në deklarime. Asistimi i qytetarëve përmes një asistenti inteligjent që ofron informacion në kohë reale, udhëzime dhe përgjigje automatike. Optimizimi i vendimmarrjes së administratës duke gjeneruar raporte të personalizuar dhe rekomandime. Përfutimet kryesore përfshijnë: Rritje të saktësisë në administrimin e të dhënave. Ulje të kostove operative dhe kohës së përpunimit. Rritje të besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve. Automatizim të proceseve të përsëritura dhe reduktim të gabimeve njerëzore. Në thelb, integrimi i AI ndihmon Bashkinë Vlorë të ndërtojë një sistem taksash dhe tarifash më të zgjuar, më efikas dhe më të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarëve.”

Nisur nga argumentimi për implementimin e AI në sistemin e taksave vendore Vlorë, Kreatx SHPK konstaton se, AI shërben si një mekanizëm lehtësues i punëve të përditshme, por AI nuk identifikon subjektet tatimpaguese, pasi kjo është detyrë e inspektorëve të taksave vendore në Bashkinë Vlorë. Po ashtu, AI nuk mund të parashikojë të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe as të zbulojë evazion fiskal apo gabimet në deklarimet tatimore, procedura këto që janë të mirëpërcaktuara në ligj. Për pasojë, implementimi i AI duhet të jetë plotësisht i argumentuar në DST nga AK.”

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në përgjigjen e dhënë ankimuesit, nëpërmjet shkresës nr. 4478/1 prot., datë 04.04.2025, me objekt: “Vendim lidhur me ankesën me nr.Protokolli 677/2026, datë 02-03-2026 ora 19:56” si dhe shkresës nr. 5958 prot., datë 26.03.2026 të autoritetit kontraktor, rezulton se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës ka pranuar pretendimet e ankimuesit si vijon:

Pika 1-Në specifikimet teknike që janë publikuar në dokumentin e veçantë bashkëlidhur DST nga AK, referohet për zbatim legjislativ për mbrojtjen e të dhënave personale. Kreatx SHPK konstaton se referohet për zbatim ligji nr.9887, datë 10.03.2008, ndërkohë që prej vitit 2024 ka hyrë në fuqi ligji nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Për pasojë, Kreatx SHPK vlerëson se, të gjitha kërkesat e posaçme të vendosura nga AK për mbrojtjen e të dhënave personale janë të paligjshme, sepse janë mbështetur në ligjin e shfuqizuar dhe në protokollin e vjetër për mbrojtjen e tyre. Aktualisht, ka hyrë në fuqi dhe zbatohet ligji nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, që bashkë me aktet nënligjore të nxjerra në bazë dhe për zbatim të tij, ka ndryshuar rregullat e zbatueshme në fuqi dhe në këto kushte kuadri ligjor i zbatueshëm duhet të zëvendësohet nga AK në DST.

- **Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK qëndron** sepse ligji nr.9887, datë 10.03.2008 i ndryshuar është shfuqizuar me nenin 99 të ligjit nr.124/2024 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, duke kërkuar modifikimin e kësaj pike në specifikimet teknike.

Pika 2- Në specifikimet teknike të publikuara në dokumentin e veçantë bashkëlidhur DST, për ruajtjen e dokumentave tatimore është shënuar afati i gabuar 5 – 10 vjet, ndërkohë që afati sipas nenit 179 të Kodit të Procedurave Administrative dhe nenit 48, pika 2, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2020, “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar, është vetëm 5 vjet. Vendosja e një afati të paligjshëm për ruajtjen e dokumentacionit në një sistem elektronik taksash vendore i bën specifikimet e DST në kundërshtim me ligjin dhe për pasojë Kreatx SHPK çmon se, afati në këtë rast duhet të zëvendësohet AK në përputhje me afatin që parashikon neni 48 i ligjit për procedurat tatimore.

- **Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK qëndron** sepse sipas nenit 48 “Mbajtja dhe ruajtja e dokumentave të të dhënave tatimore”, pika 2 të ligjit nr.9920, datë 19.05.2020, “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar, citohet se: “Të dhënat dhe informacioni financiar e kontabël ruhet nga tatimpaguesi, për të paktën 5 vjet, duke filluar nga fundi i vitit tatimor, të cilit i përkasin dokumentat.”

Së treti: Në shtojcën nr.7, AK ka përcaktuar grafikun e shërbimeve dhe të ekzekutimit, që shërben edhe si tabelë orientuese për të depozituar ofertën ekonomike me zërat e shërbimeve për njësi dhe në total nga OE. Kreatx SHPK vëren se kjo tabelë është e pasaktë, pasi nuk kuptohet si janë ndarë zërat e mirëmbajtjes dhe të implementimit në raport me kohëzgjatjen e tyre. Kreatx SHPK vëren se kjo tabelë është e pasaktë, pasi nuk kuptohet si janë ndarë zërat e mirëmbajtjes dhe të implementimit në raport me kohëzgjatjen e tyre. Kreatx SHPK e ka të pamundur që të kuptojë nëse kontrata zgjat 12 muaj apo 24 muaj, pasi AK nga njëra anë shprehet në DST se, afati i implementimit është 12 muaj, ndërsa nga ana tjetër citon se afati i mirëmbajtjes së sistemit të ri të implementuar është 12 muaj nga momenti që mbaron implementimi.

Pika 4- Sa i takon grafikun të ekzekutimit që AK ka vendosur në DST, Kreatx SHPK vëren se është i paplotë, pasi është përgjysmë dhe përfshin vetëm 5 muajt e parë të ekzekutimit të kontratës, ndonëse shërbimet sipas kontratës presupozohen që të zgjasin për 12 apo 24 muaj. Pra, edhe në këtë drejtim AK duhet të plotësojë saktë DST.

Grafiku i paplotë i ekzekutimit të shërbimeve që ka vendosur AK paraqitet si më poshtë: Shërbimet që kërkohen: 12 muaj

Afatet e ekzekutimit: 12 MUAJ

Faza	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5
Analiza & Blueprint	1	1	0	0	0
Zhvillimi Moduleve Bazë	0	1	1	1	0
Infrastruktura & Siguria	0	1	0	0	0
Integrimet	0	0	1	1	0
Migrimi i të Dhënave	0	0	1	0	0
Testimi	0	0	1	0	0

Trajnimet	0	0	0	1	0
Go-Live & Cutover	0	0	0	1	0
Hypercare	0	0	0	1	1

Përveç sa më lart, Kreatx SHPK vëren se, mes formularit të ofertës ekonomike dhe grafikut të ekzekutimit ka dallime sa i përket zërave të shërbimit që duhet të përmbushen nga kontraktori. Këto dallime janë të atij lloji që, i pamundësojnë OE ofertues të paraqesin një ofertë ekonomike në përputhje me LPP dhe RRPP dhe i pamundësojnë OE ofertues që të përlllogarisin saktë vlerën e ofertës ekonomike drejtuar AK. Këto mospërputhje dhe konfuzione mes grafikut të ekzekutimit dhe formularit të ofertës ekonomike dhe pasaktësitë e rënda në drejtim të zërave të ndryshëm të shërbimeve, shërbejnë si shkak që AK të rregullojë DST vetëm përmes anulimit të kësaj procedure prokurimi publik, sipas nenit 98, pika 1, shkronja “c”, të LPP, duke ngarkuar në SPE DST të reja dhe duke shpallur një prokurim të ri.

- **Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik Kreatx qëndron** sepse në grafikun e ekzekutimit nuk janë përfshirë të 12 muajt si dhe përcaktimi i saktë i secilit zë preventivi sipas afatit të tyre të ekzekutimit, duke ndikuar në formulimin e ofertës ekonomike nga operatorët pjesëmarrës, duke kërkuar modifikimin e grafikut për të 12 muajt.

Faza	Muaji 1	Muaji 2	Muaji 3	Muaji 4	Muaji 5	Muaji 6	Muaji 7	Muaji 8	Muaji 9	Muaji 10	Muaji 11	Muaji 12
Analiza & Blueprint			0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Zhvillimi Moduleve Bazë	0				0	0	0	0	0	0	0	0
Infrastruktura & Siguria	0		0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Integrimet	0	0			0	0	0	0	0	0	0	0
Migrimi i të Dhënave	0	0		0	0	0	0	0	0	0	0	0
Testimi	0	0		0	0	0	0	0	0	0	0	0
Trajnimet	0	0	0									
Vendosje Online	0	0	0		0	0	0	0	0	0	0	0
Mirembajtje	0	0	0									

Pika 5- Në shtojcën nr.9, pika 2, të DST, për numrin e punonjësve, AK përcakton se, operatori ekonomik duhet të disponojë një punësim mesatar të paktën 7 (pesëmbëdhjetë) punonjës të punësuar, të cilët të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 6 (gjashtë) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave vërtetuar me: Kreatx SHPK konstaton se, kërkesa e posaçme për numrin e punonjësve është e paqartë, pasi nuk kuptohet nëse bëhet fjalë për 7 apo 15 punonjës. Nëse bëhet fjalë për 15 punonjës, ky numër është i paargumentuar në DST, pasi AK nuk jep shpjegime mjaftueshëm për një kërkesë kaq të lartë punonjësish në raport me vlerën e prokurimit, nevojat e prokurimit dhe të AK, si dhe praktikën administrative të prokurimit publik në përgjithësi në Shqipëri. Për pasojë, kjo kërkesë e posaçme duhet të rregullohet nga AK, duke ulur numtin e punonjësve nga 15 që është përcaktuar dhe duke anuluar procedurën e prokurimit dhe duke zhvilluar një procedurë të re prokurimi nga e para.

- **Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik Kreatx nuk qëndron** sepse sipas koordinimit të APP-së dt.27.02.2026 dhe nenit 75 të LPP-së janë bërë ndryshimet përkatëse të dokumentave të tenderit.

Lidhur me këtë pretendim, megjithëse përgjigja e autoritetit kontraktor është mospranim, nga verifikimi në SPE rezulton se Bashkia Vlorë ka publikuar në SPE një shtojcë ku gjen pasqyrim pranimi i pretendimeve të sipërcituara të ankimuesit.

Pika 7- Në shtojcën nr.9 të DST, AK ka vendosur si kërkesa të posaçme certifikimet e punonjësve si më poshtë:

1. OE duhet të këtë 1 zhvillues senior në teknologjinë Net ose ekuivalent me të paktën 3-5 vite ekperiencë.
2. OE duhet të këtë 1 zhvillues senior në teknologjinë Oracle Database Administrator ose ekuivalent me të paktën 3-5 vite ekperiencë.
3. Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent.
4. Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert Database Administrator në Oracle dhe të certifikuar për Oracle Database 11g: SQL Fundamentals I (1Z0-051), Oracle Database Security Audit dhe Omega Core Audit.
5. Operatorit Ekonomik duhet të vërtetojë marrëdhënien e bashkëpunimit me ekspert Backend Developer i certifikuar nga Google Cloud.
6. Operatori Ekonomik duhet të vërtetojë se ka në marrëdhënie bashkëpunimi të paktën një Ekspert në Sigurimin e Cilësisë së Softuerit (QA).
7. Ekspert në menaxhimin e projekteve (Ky nuk është vendosur fare tek certifikimet, por tek pjesa e argumentimit të vendosur në DST).

Kreatx SHPK vëren se për certifikimet me nr.1 dhe nr.2, kërkohet përvojë nga 3 deri në 5 vjet dhe mënyra e hartimit të kërkesës së posaçme është krejtësisht konfuzë dhe e paqartë, edhe po të shohësh procesverbalin e argumentimit. Pra, në titullin e certifikimit të posaçëm AK ka caktuar përvojën prej 3 vjet, ndërsa në pjesën argumentuese të tij, certifikimi shënohet me përvojën 5 vjet. Këto paqartësi të dukshme përbëjnë shkelje të rënda të neneve 41 të LPP dhe 36 të RRPP, sipas të cilëve kërkesat e vendosura në DST duhet të jenë të qarta për ofertuesit, në përputhje me nevojat e AK, me qëllim që OE të ketë mundësinë të paraqesë ofertën ekonomike sipas LPP.

Në shtesë të argumentave më lart, vendosja e përvojës për punonjësit e certifikuar është paksa kontradiktore, pasi AK nuk e mat dot përvojën mbi bazë certifikimi, por vetëm mbi bazë vjetërsie pune. Kjo pasi, ka punonjës që mund të jenë certifikuar, por nuk kanë ushtruar veprimtari për 3 apo 5 vjet me radhë për veprimtarinë që janë certifikuar. Pra, në praktikë, mbetet faktikisht e paprovuar nëse punonjësi ka përvojë 3 apo 5 vite për një certifikim të posaçëm. Nga ana tjetër, po një punonjës që ka 10 vjet që është certifikuar, e përmbush apo jo kërkesën e posaçme, n kushtet kur kërkon 3 – 5 vite përvojë për certifikim ? Një kufizim me 3 – 5 vjet përvojë për certifikim, është i pajustificuar në raport me nevojat e prokurimit, i pajustificuar në raport me nevojat e AK, si dhe me vetë përcaktimet e LPP dhe RRPP. Theksojmë se, sipas KPP, certifikimet vendosen nga ana e AK për OE ofertues, me qëllim që AK të kuptojë nëse OE i ka apo jo kapacitetet për të përmbushur detyrimet kontraktore, e jo për të kufizuar në mënyrë abuzive konkurrencën në prokurimin publik siç ka vepruar Bashkia Vlorë në këtë rast.

Pra, AK duhet të ndryshojë DST dhe të heqë përvojën për certifikimet me nr.1 dhe nr.2 sipas argumentit të paraqitur në këtë ankim administrativ.

Përsa i përket kërkesës së posaçme për ekspert auditues të certifikuar me CISA (Certified Information Systems Auditor), CISO (Chief Information Security Officer) ose ekuivalent, Kreatx SHPK vlerëson se ajo është hartuar gabim, pasi me një kërkesë të posaçme janë vendosur dy certifikime të ndryshme. AK duhet të kishte ndarë certifikimet CISO dhe CISA nga njëra-tjetra, për sa kohë që janë të ndryshme ose duhet të kishte shprehur për natyrën alternative të tyre, me qëllim që OE ofertues të kuptonin që plotësimi i njërit prej tyre e bënte ofertën e ekonomike të kualifikueshme në raport me këtë kërkesë.

Përsa i përket kërkesës së posaçme për ekspert Database Administrator në Oracle dhe të certifikuar për Oracle Database 11g: SQL Fundamentals I (1Z0-051), Oracle Database Security Audit dhe Omega Core Audit, Kreatx SHPK vëren se kjo kërkesë e posaçme, nuk është e qartë, pasi nga mënyra sesi është shkruar në DST nuk kuptohet nëse kërkohen punonjës me certifikime alternative apo kumulative. Pra, nëse ofertuesi duhet të depozitojë dokumentacion për punonjës edhe si Oracle Database Security edhe si Oracle Database SQL edhe për Omega Core Audit apo mjafton që ofertuesi të paraqesë dokumentacion vetëm për njërin prej tyre, me qëllim që të përmbushet kërkesa e posaçme në DST.

Po kështu, AK nuk argumenton nevojën e tre certifikimeve të ndryshme, e madje nuk shpjegon as ekuivalencën mes tyre. Theksojmë se, nëse databaza e sistemit të taksave vendore pranë Bashkisë Vlorë do të jetë Oracle, nuk ka nevojë për sistem Omega Core Audit. Vendosja e katër certifikimeve të ndryshme në një kërkesë të posaçme, që duhen ndarë sipas LPP, sjell konfuzion dhe paqartësi për OE të cilët e kanë të pamundur për të ofertuar sipas LPP dhe RRPP. Kërkesa e certifikimit të trefishtë nuk justifikohet as në procesverbalin e argumentimit nga AK, e prandaj duhen rregulluar edhe një herë nga e para DST, duke anuluar këtë procedurë prokurimi dhe duke shpallur një të re në SPE.

Përsa i përket kërkesës së posaçme për ekspert Backend Developer të certifikuar nga Google Cloud, Kreatx SHPK vëren se kërkesa është abuzive, pasi AK ka vendosur një certifikim të dedikuar nga Google pa përdorur termin ekuivalent siç e kërkon neni 36 i RRPP. Po ashtu, kërkesa është e pajustificuar për nevojat e prokurimit publik, pasi certifikimet back-end janë të llojeve të ndryshme në tregun e lirë dhe nuk ka përse të jenë të dedikuar vetëm për Google, pasi AK nuk paraqet asnjë nevojë për shërbime nga Google. Duke qenë një certifikim i pajustificuar as në procesverbal dhe as nga nevojat e prokurimit publik, dallohet qartë se kërkesa e posaçme është vendosur nga AK në kundërshtim me LPP, me qëllimin e vetëm të kufizimit të OE ofertues për të marrë pjesë në prokurimin publik.

Sa i përket kërkesës së posaçme për ekspert në sigurimin e cilësisë së softuerit (QA), Kreatx SHPK vëren se nuk është argumentuar nevoja e një kërkesë të këtillë të tillë në procesverbalin e argumentimit nga AK. Për pasojë, mbajtja e një kërkesë të tillë në DST duhet të argumentohet nga AK ose në të kundërt duhet të hiqet prej tyre.

Në lidhje me kërkesën e posaçme për ekspert në menaxhimin e projekteve, Kreatx SHPK konstaton se kjo kërkesë nuk është vendosur tek certifikimet, por vetëm tek pjesa e argumentimit të tyre në DST. Prandaj, AK duhet të rregullojë DST edhe sa i takon kësaj kërkesë të posaçme,

me qëllim që DST të jenë transparente në raport me OE ofertues që kanë dëshirë të marrin pjesë në tender.

Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik Kreatx qëndron duke kërkuar ndryshimin e këtij kriteri konkretisht:

2.5 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar të diplomuar në një nga degët e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion, me kompetencat minimalisht si më poshtë:

1. Zhvillues Senior në teknologjinë .NET (minimumi 3 vite eksperiencë) ose ekuivalente

Teknologjia .NET përdoret për ndërtimin e logjikës së biznesit dhe arkitekturës së sistemit. Eksperiencia minimale 5-vjeçare garanton: Projektim arkitekturor të qëndrueshëm; Zhvillim të sigurt dhe të optimizuar; Mirëmbajtje dhe shkallëzim afatgjatë të sistemit. Kërkesa është e lidhur drejtpërdrejt me realizimin korrekt të sistemit dhe proporcional me kompleksitetin e tij.

2. Administrator i Bazës së të Dhënave – Oracle (minimumi 3 vite eksperiencë) ose ekuivalente

Sistemi përpunon volume të konsiderueshme të dhënash financiare dhe tatimore. Ekspertiza në Oracle Database garanton: Integritet të të dhënave; bPerformancë të optimizuar; Siguri dhe mekanizma rikuperimi (backup & recovery); Auditueshmëri të transaksioneve financiare.

3. Ekspert auditues i certifikuar (CISA, CISO ose ekuivalent) ose ekuivalente

Certifikimi si CISA ose ekspertizë në nivel CISO siguron: Auditueshmëri të proceseve; Kontroll të brendshëm IT; Vlerësim të rreziqeve teknologjike; Përputhshmëri me standarde ndërkombëtare të kontrollit dhe sigurisë. Në një sistem fiskal, gjurmueshmëria dhe kontrolli janë elementë thelbësorë.

4. Ekspert Oracle i certifikuar (SQL Fundamentals, Security Audit) ose ekuivalente

Certifikimet specifike në Oracle dëshmojnë: Njohuri të thelluara në menaxhimin e bazave të të dhënave; Implementim të sigurt të strukturës së të dhënave; Audit të brendshëm të konfigurimeve të sigurisë. Kjo është e domosdoshme për mbrojtjen e të dhënave tatimore.

5. Ekspert në Menaxhimin e Projekteve ose ekuivalente

Projekti kërkon: Planifikim të detajuar; Menaxhim të riskut; Koordinim të ekipeve multidisiplinare; Respektim të afateve dhe buxhetit.

6. Ekspert në Sigurinë Kibernetike ose ekuivalente

Sistemi i taksave është objekt me risk të lartë për sulme kibernetike. Eksperti garanton: Analizë të cenueshmërisë; Testim penetrimi; Hardening të infrastrukturës; Monitorim të vazhdueshëm të sigurisë.

7. Ekspert në Sigurimin e Cilësisë (QA) ose ekuivalente

Për shkak të ndikimit financiar të sistemit, çdo gabim funksional mund të shkaktojë pasoja ekonomike dhe ligjore. Eksperti QA siguron: Testim funksional; Testim performance; Testim sigurie; Verifikim përputhshmërie me kërkesat teknike.

Pika 8- : *Në shtojcën nr.9 të DST, AK ka përcaktuar se: “Për personeli nevojitet dorëzimi i këtyre dokumentave (...) Certifikata/Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar; Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B; Kontratë punë.; Cv; Kontratat e bashkëpunimit.”.*

Kreatx SHPK çmon se, dokumentacioni i kërkuar për stafin është shkruar në mënyrë të paqartë për sa i përket kontratave të bashkëpunimit. Kjo pasi, sipas LPP dhe RRPP, OE ofertues që duan të marrin pjesë në tender kanë mundësi që të depozitojnë një ofertë ekonomike të vlefshme sa i takon stafit dhe personelit teknik në këto forma:

- 1. Duke disponuar punonjës me kontrata pune si punonjës të tyre;*
- 2. Duke u bashkuar me një operator tjetër ekonomik ofertues për të siguar stafin e nevojshëm të certifikuar në mënyrë të plotë si BOE;*
- 3. Duke u mbështetur tek kapacitetet e një operatori tjetër ekonomik, pa kaluar 50 % të detyrimeve kontraktore, që në masën mbi 50% të tyre duhet të përmbushen nga ofertuesi.*

Duke ju referuar tre mënyrave të ofertimit siç përcaktojnë LPP dhe RRPP më lart, vendosja e një kërkesë të posaçme për të dëshmuar stafin e nevojshëm me kontrata bashkëpunimi, lë hapësira për abuzivitet nga OE ofertues, pasi ata mund të kontraktojnë staf të certifikuar sipas kërkesave të vendosura në DST me çdolloj personi, edhe nëse ky nuk rezulton si subjekt tregtar në qarkullimin civil sipas ligjit organik për tregtarët dhe shoqërinë tregtare. Kjo sjellje mund të bjerë në kundërshtim me legjislacionin e punës dhe rekomandimet e Inspektoratit të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, që nuk i legjitimon kontratat e bashkëpunimi me persona fizikë të papajisur me NUIS sipas legjislacionit për tregtarët dhe shoqëritë tregtare. Vendosja e kontratave të bashkëpunimit kaq gjerë lë hapësirë për ofertime nga OE që shkelin legjislacionin e punës, me persona fizikë që nuk shlyejnë detyrimet e taksave, tatimeve dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore. Po ashtu, kjo mund të bëhet shkak që

gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, AK të ndeshet me ofertues që nuk janë të pavarur, pasi i njëjti person fizik mund të kontraktohet me bashkëpunim për efekt të certifikimit të tij nga disa OE ofertues në tender.

Për rrjedhojë, AK duhet të sqarojë se në DST se do të pranohen të vlefshme vetëm ofertues kontrata bashkëpunimi të lidhura me persona fizikë tregtarë dhe jo çfarëdolloj personi fizik. Së fundi; Në dokumentacionin e specifikimeve teknike bashkëngjitur DST, AK citon se, sistemi i taksave vendore të Bashkisë Vlorë do të përdorë AI për arsyet e mëposhtme: “XI. Integrimi i një moduli të inteligjencës artificiale në Sistemin e ri të Taksave dhe Tarifave vendore të Bashkisë Vlorë. (..) Ky modul do të automatizojë procese kyçe si: Identifikimi i subjekteve tatimpaguese dhe verifikimi i të dhënave të tyre duke përdorur algoritme analitike. Parashikimi i të ardhurave, bazuar në të dhënat historike dhe modelet e konsumit apo veprimtarisë ekonomike. Zbulimi i rasteve anormale si mospërputhje, evazion potencial ose gabime në deklarime. Asistimi i qytetarëve përmes një asistenti inteligjent që ofron informacion në kohë reale, udhëzime dhe përgjigje automatike. Optimizimi i vendimmarrjes së administratës duke gjeneruar raporte të personalizuar dhe rekomandime. Përfitimet kryesore përfshijnë: Rritje të saktësisë në administrimin e të dhënave. Ulje të kostove operative dhe kohës së përpunimit. Rritje të besueshmërisë dhe transparencës ndaj qytetarëve. Automatizim të proceseve të përsëritura dhe reduktim të gabimeve njerëzore. Në thelb, integrimi i AI ndihmon Bashkinë Vlorë të ndërtojë një sistem taksash dhe tarifash më të zgjuar, më efikas dhe më të orientuar drejt shërbimit ndaj qytetarëve.”

Nisur nga argumentimi për implementimin e AI në sistemin e taksave vendore Vlorë, Kreatx SHPK konstaton se, AI shërben si një mekanizëm lehtësues i punëve të përditshme, por AI nuk identifikon subjektet tatimpaguese, pasi kjo është detyrë e inspektorëve të taksave vendore në Bashkinë Vlorë. Po ashtu, AI nuk mund të parashikojë të ardhurat e njësisë së vetëqeverisjes vendore dhe as të zbulojë evazion fiskal apo gabimet në deklarimet tatimore, procedura këto që janë të mirëpërcaktuara në ligj. Për pasojë, implementimi i AI duhet të jetë plotësisht i argumentuar në DST nga AK.”

Në lidhje me këtë pikë ankesa e operatorit ekonomik Kreatx qëndron, duke kërkuar ndryshime të këtij kriteri konkretisht:

2.5 Për të garantuar implementimin me sukses të kontratës, cilësinë e shërbimit të ofruar si dhe për të garantuar suportin përgjatë periudhës së parashikuar të mirëmbajtjes sipas dokumentit të termave të referencës, operatori ekonomik ofertues duhet të disponojë staf të kualifikuar të diplomuar në një nga degët e Inxhinierisë Elektronike, Inxhinieri Informatike, Teknologji Informacioni, Informatikë, Informatikë Matematikë, Inxhinieri Matematike dhe Informatike, Informatikë Ekonomike, Telekomunikacion, Inxhinieri Telekomunikacion, me kompetencat minimalisht si më poshtë:

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin:

- Certifikata/ Transkriptet përkatëse për specialistët e kërkuar;

- *Deklarimin nga Operatori Ekonomik të personelit teknik/ profilin e punonjësve nëpërmjet paraqitjes së formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10, pjesa III, pika B; me kontrate Bashkëpunimi*
- *Kontratë punë.*
- *Cv*
- *Kontratat e bashkëpunimit*

Në përmbyllje vlerësojmë se pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik Kreatx SHPK ptanohen për pikat 1,2,6,7 dhe pika 8 të ankesës dhe rrëzohet për pikën 3 dhe pikën 5 të kriterëve të vendosura nga Njësia e Prokurimit.”

III.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.”

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argum entet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.”

Për pasojë Komisioni i Prokurimit Publik, referuar nenit 115 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si më sipër cituar, vendos të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik ankimues për procedurën e mësipërme të prokurimit, dhe të vijojë procedurën e shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK se:

“Së treti:

Tabela e grafikut të shërbimeve, të ekzekutimeve dhe të ofertimeve që ka vendosur AK paraqitet si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi i Shërbimit	Vlera e Parashikuar Pa TVSH (ALL)
1.	Implementimin e Sistemit të ri te Taksave dhe Tarifave Vendore	
2.	Analizë dhe Migrim i të dhënave historike nga Microsoft Navison R2 në Sistemit të ri te Taksave dhe Tarifave Vendore	
3.	Testim, trajnime të stafit dhe dokumentacion	
4	Shërbim të dedikuar Cloud + Backup	
5	Mirëmbajtje dhe Mbështetje pas implementimit (12 muaj)	
	TOTALI pa TVSH	
	TVSH 20%	
	TOTALI pa TVSH	

Paqartësia e mësipërme për afatin e zbatimit të kontratës për një periudhë prej 12 muajsh, shoqërohet edhe me një problematikë tjetër në tabelën e ofertimit në DST, ku të dyja vlerat e shënuara brenda saj janë pa TVSH, ndonëse sipas LPP dhe RRPP vlerat e ofertës duhet të paraqiten në tabelë pa TVSH dhe me TVSH. Si rezultat, AK duhet të rregullojë edhe tabelën e ofertimit.”

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, relacionin teknik të publikuar në SPE është parashikuar si vijon:

Lista e shërbime:

Nr.	Përshkrimi i Shërbimit	Vlera e Parashikuar Pa T.V.SH (ALL)
1	Implementimin e Sistemit të ri te Taksave dhe Tarifave Vendore	

2	<i>Analizë dhe Migrim i të dhënave historike nga Microsoft Navison R2 në Sistemit të ri te Taksave dhe Tarifave Vendore</i>	
3	<i>Testim, trajnime të stafit dhe dokumentacion</i>	
4	<i>Shërbim të dedikuar Cloud + Backup</i>	
5	<i>Mirëmbajtje dhe Mbështetje pas implementimit (12 muaj)</i>	
	TOTALI pa T.V.SH	
	T.V.SH 20%	
	TOTALI pa T.V.SH	

III.2.2. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.2.3. Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon, se zbatimi i parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato.

III.2.5. Sa më sipër Komisioni I Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të korrigjoje rrjeshtin e fundit të tabelës së sipërcituar lidhur me kërkesën “TOTALI pa T.V.SH”, duke e korrigjuar në “TOTALI me T.V.SH”,

Pretendimet e ankimesit qëndrojnë.

III.3.Lidhur me pretendimet e ankimesit se: “[...] mes formularit të ofertës ekonomike dhe grafikut të ekzekutimit ka dallime sa i përket zërave të shërbimit që duhet të përmbushen nga kontraktori. Këto dallime janë të atij lloji që, i pamundësojnë OE ofertues të paraqesin një ofertë ekonomike”, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë sqarim, për sa pretendohet.

III.3.1. Në nenin 2 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

III.3.2. Në nenin 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:

1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.3.3. Në nenin 21 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi

III.3.4. KPP thekson, se një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit, është ai bazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose

kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Me marrjen pjesë në procedurën e prokurimit, operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. KPP gjykon, se zbatimi i parimit të transparencës, barazisë, dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime, ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion të barabartë, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur vlerësohen ato.

III.3.5. Në rastin konkret rezulton se në shtojcën 2, nga ana e autoritetit kontraktor janë përcaktuar elementët e ofertës ekonomike dhe konkretisht janë përcaktuar zërat: 1. Implementimin e Sistemit të ri të Taksave dhe Tarifave Vendore; 2. Analizë dhe Migrim i të dhënave historike nga Microsoft Navision R2 në Sistemit të ri të Taksave dhe Tarifave Vendore; 3. Testim, trajnime të stafit dhe dokumentacion; 4. Shërbim të dedikuar Cloud + Backup dhe 5. Mirëmbajtje dhe Mbështetje pas implementimit (12 muaj), ndërsa në shtojcën 7 “*Formulari i shërbimeve dhe grafikut të ekzekutimit*”, janë përcaktuar zërat: 1. Analiza & Blueprint; 2. Zhvillimi Moduleve Bazë; 3. Infrastruktura & Siguria; 4. Integrimet; 5. Migrimi i të Dhënave; 6. Testimi; 7. Trajnimet; 8. Go-Live & Cutover dhe 9. Hypercare, të cilat nuk janë të njëjta me ato të përcaktuara në shtojcën 2 nga AK, duke krijuar konfuzion tek ofertuesit për përgatitjen e ofertës ekonomike

Dokumentet e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 2 të LPP i cili parashikon shprehimisht se: “*Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*”

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “*Për kërkesat e vendosura në shtojcën nr.9, në lidhje me ISO, AK përcakton se, OE ofertues duhet të zotërojë midis të tjerave ISO 42001:2023 dhe ISO 22301:2019. Kreatx SHPK vëren se, ISO 42001:2023 është një ISO që certifikon subjektet tregtare për menaxhimin e inteligjencës artificiale, ndërsa ISO 22301:2019 është një ISO që certifikon subjektet tregtare për planet e menaxhimit të biznesit. Kreatx SHPK vëren se, vendosja e këtyre dy ISO-ve nga ana e AK është e pajustificuar dhe e paargumentuar nga AK për arsyet e mëposhtme:*

Për ISO 42001:2023, në Republikën e Shqipërisë nuk ka asnjë subjekt tregtar të certifikuar për menaxhimin e inteligjencës artificiale. Për këtë mund të shikoni edhe faqen e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit dhe atë të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit, që nuk kanë asnjë subjekt tregtar të certifikuar për këto ISO. Madje as nuk e njohin aspak një ISO të tillë.

Për më tepër, nga informacioni që disponon Kreatx SHPK, nuk rezulton të jetë ketë asnjë subjekt privat apo shtetëror të akredituar nga DPA në vendin tonë, që të inspektojë apo lëshojë certifikatë të tillë ISO. Duke mos u gjendur një certifikatë e tillë në tregun tonë të brendshëm, kuptohet që kërkesa e vendosur nga AK është e paligjshme, jokoherente në raport me situatën faktike duhet hequr nga DST.

Gjithashtu, nga përmbajtja e specifikimeve teknike të DST, AK e justifikon përdorimin e AI me faktin e përlllogaritjes së taksave vendore, me parashikimet për mbledhjen e tyre, me përgatitjen e dokumentave të kontrollit e të inspektimit të njësisë së taksave vendore pranë Bashkisë Vlorë, etj., veprime këto që janë të përcaktuara shprehimisht në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar dhe në vendimet e Këshillit Bashkiak Vlorë, për të cilat nuk nevojitet përdorimi i AI, për sa kohë që i përcakton legjislacioni i zbatueshëm në fuqi mjaft mirë.

Në kushtet kur AI është thjesht një mjet ndihmës dhe nevojat që AK e justifikojnë përdorimin e AI për shërbime që janë të mirëpërcaktuara me ligj dhe akte nënligjore, vendosja e një ISO kaq të posaçme, thjesht kufizon konkurrencën për OE ofertues qëllimisht. Pra, jemi përpara një kufizimi të paligjshëm e të dëmshëm e me keqdashësi të konkurrencës në prokurimin publik.

Ndërkohë, ISO 22301:2019, nënkupton që OE ofertues të ketë planin e vazhdimin të biznesit në rast incidenti dhe si e tillë është një certifikim që nuk nevojitet për këtë prokurim publik, për sa kohë që me VKM nr.813, datë 30.12.2025, janë miratuar masat teknike, operacionale dhe organizative të operatorëve që disponojnë infrastruktura kritike dhe të rëndësishme. Sipas VKM nr.813/2025, çdo autoritet publik apo privat tashmë me stadardet e reja të sigurisë kibernetike, ka detyrimin ligjor që të respektojë dhe zbatojë këto masa, duke përfshirë ndër të tjera edhe një plan për vazhdimin e biznesit dhe një plan për Disaster Recovery. Për rrjedhojë, vendosja e ISO 22301:2019 si një standard i posaçëm për ofertuesit, bie ndesh me kuadrin ligjor në fuqi, që i detyron operatorët ekonomikë ofertues t`a kenë një BCP në rastet kur implementojnë dhe mirëmbajnë sisteme të infrastrukturës të rëndësishme ose kritike.

6Pra, për sa kohë që BCP është tashmë detyrim ligjor për subjektet tregtare në fushën e TIK dhe përbën një situatë të zakonshme, AK nuk mund t`a përdorë ISO 22301:2019 si standard kualifikues/skualifikues për ofertuesit gjatë prokurimit publik.

Për pasojë, AK nuk ka justifikuar vendosjen e këtyre ISO në DST dhe si të tilla ato duhet të hiqen nga dokumentacioni i tenderit, pasi të jetë anuluar procedura e prokurimit publik dhe të jetë 1% rishpallur në SPE në përputhje me LPP”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1.Në Shtojcën 9 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.4 e dokumentave të tenderit të publikuara në SPE, rezulton se nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar plotësimi i kriterëve si më poshtë vijon:

2.4 Operatori ekonomik duhet të jetë i çertifikuar me:

a) Standardin ISO 9001 (e përditësuar), për sistemin e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente objekt i të cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme) dhe të lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt-marrëveshjes.

b) Standardin ISO 27001 (e përditësuar) për sistemin e menaxhimit të sigurisë së informacionit ose ekuivalente objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.

c) Standartin ISO 42001:2023 – (e përditësuar) për Sistemin e menaxhimit për Inteligjencën Artificiale ose ekuivalente objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.

d) Standartin ISO 22301:2019 ose ekuivalente (e përditësuar) për Menaxhimi i Vazhdimësisë së Biznesit ose objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.

e) Standartin ISO 20000-1:2018 ose ekuivalente (e përditësuar) për Sistemi i Menaxhimit të Shërbimeve të Teknologjisë së Informacionit, objekt i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit (e vlefshme, dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë).

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër të realizojë referuar akt- marrëveshjes.

III.4.2. Në përgjigjen e dhënë ankimesit, nëpërmjet shkresës nr. 4478/2 prot., datë 04.03.2026, KSHA-ja ka argumentuar si vijon:

“Autoriteti Kontraktor ka vendosur kërkesën që Operatori Ekonomik ofertues të zotërojë ISO 42001:2023 dhe ISO 22301:2019, si standarde ndërkombëtare të menaxhimit, për të garantuar realizimin me cilësi, siguri dhe qëndrueshmëri të shërbimeve në funksion të interesit publik dhe të punës së Bashkisë.

1. ISO 42001:2023 — Menaxhimi i Sistemeve të Inteligjencës Artificiale

ISO 42001:2023 është standardi i parë ndërkombëtar për sistemet e menaxhimit të inteligjencës artificiale. Ai siguron që përdorimi i AI të jetë i kontrolluar dhe i dokumentuar, të garantojë transparencë dhe gjurmueshmëri të proceseve, të menaxhojë rreziqet që lidhen me automatizimin dhe vendimmarrjen dhe të respektojë parimet e etikës, sigurisë dhe mbrojtjes së të dhënave.

Përdorimi i AI në sistemi e taksave dhe tarifave Vendore do të bëjë llogaritje më të sakta dhe të detajuara të çdo lloji takse, gjore, etj pasi Inteligjences Artificiale nuk përben zgjedhje selektive në asnjë lloj aspekti, kjo gjë ndikon ndjeshëm tek buxheti i shtetit.

Në kushtet kur projekti përfshin përdorimin e teknologjive digjitale dhe elementëve të AI në përpunimin e të dhënave apo optimizimin e proceseve administrative, kërkesa për këtë standard synon të minimizojë rreziqet ligjore dhe operacionale, të garantojë integritetin e të dhënave publike, të sigurojë që sistemi të funksionojë në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare.

Kjo kërkesë nuk vendoset për të kufizuar konkurrencën, por për të siguruar që operatori ekonomik të ketë kapacitete të strukturuar dhe të audituara për menaxhimin e AI.

2. ISO 22301:2019 — Sistemi i Menaxhimit të Vazhdimësisë së Biznesit (BCMS)

ISO 22301:2019 është standard ndërkombëtar për menaxhimin e vazhdimësisë së biznesit (Business Continuity Management System — BCMS)

Ky standard garanton që operatori ekonomik ka një plan të Vazhdimësisë së Biznesit (BCP), ka plane të dokumentuara për Disaster Recovery, është i përgatitur për situata emergjente (sulme kibernetike, ndërprerje sistemesh, fatkeqësi natyrore, etj.) dhe siguron vazhdimësinë e shërbimeve publike pa ndërprerje.

Shërbimet që lidhen me administratën vendore, sistemet e të dhënave dhe infrastrukturën digjitale nuk mund të ndërpriten, pasi prekin drejtpërdrejtë interesin publik dhe funksionimin e Bashkisë. Për këtë arsye, kërkesa për ISO 22301:2019 synon të mbrojë interesin publik, sigurojë vazhdimësinë e shërbimeve ndaj qytetarëve, reduktojë riskun financiar dhe operacional për institucionin.

Përputhshmëria me parimet e prokurimit publik dhe Vendosija e këtyre standardeve lidhet drejtpërdrejt me objektin e kontratës, është proporcionale me rëndësinë dhe kompleksitetin e shërbimit, garanton cilësi, siguri dhe qëndrueshmëri afatgjatë, mbështetet në standardet ndërkombëtare të njohura globalisht.

Qëllimi i Autoritetit kontraktor nuk është kufizimi i konkurrencës, por garantimi që operatorët ekonomikë të disponojnë sisteme të certifikuara menaxhimi që sigurojnë performancë të qëndrueshme, menaxhim risku dhe mbrojtje të interesit publik.”

III.4.3. Në nenin 2 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 21 pika 1 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.

Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”

III.4.4. Në nenin 77 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht si vijon:

1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. [...]

4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoje që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.

III.4.5. Ndërsa në nenin 79 të ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. Autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dorëzimin e certifikatave ose dokumenteve të ngjashme, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e tyre me standardet e kërkuara të cilësisë, veçanërisht sa i takon:

a) garantimit të aksesit të personave me aftësi të kufizuara;

b) efikasitetit të energjisë;

c) sistemeve të menaxhimit mjedisor.

3. Në rastet kur operatori ekonomik provon se nuk mund të pajiset me një certifikatë të tillë brenda një kohe të arsyeshme për arsye që nuk varen prej tij, autoriteti ose enti kontraktor mund të pranojë dokumente të tjera, nëpërmjet të cilave mund të provohet garantimi i standardeve të kërkuara.

4. Në çdo rast, certifikatat e kërkuara duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit.

III.4.6. Neni 41, Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve pika 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht:

“3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.4.7. Komisioni i Prokurimit Publik vëren, se Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt-prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat apo shërbimin që kërkon, por këto kërkesa duhet të jenë të lidhura me objektin e prokurimit, në mënyrë që të mos rëndojnë pa të drejtë pozitat e operatorëve ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. KPP thekson faktin, se kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik, në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e bizneseve si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura. Në varësi të objektit të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Bazuar në LPP, vendosja e kërkesave për kualifikim në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë që shfaqin interes për të marrë pjesë në procedurën e prokurimit. Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ajo e dukshme, apo jo, të cilat kanë të njëjtin efekt.

III.4.8. Në lidhje me kërkesën e autoritetit kontraktor për disponimin e certifikatave, objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon të ndalet në një test proporcionaliteti, së pari, nëse kërkesat në fjalë janë të përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse këto kërkesa shkojnë përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Referuar objektit të prokurimit rezulton se autoriteti kontraktor kërkon të prokurojë shërbimin për *implementimin e sistemit të ri dixhital të taksave dhe tarifave vendore* dhe në përgjigje të testit të mësipërm të proporcionalitetit, kërkesat për disponimin e certifikatave objekt ankimi: *ISO 42001:2023 dhe ISO 22301:2019*, janë kërkesa të paargumentuara, për më tepër që nga ana e autoritetit kontraktor nuk është publikuar në SPE procesverbali *“PER ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PER KUALIFIKIM”*. KPP gjykon se lidhur me kërkesën e autoritetit kontraktor në objekt ankimi, ky i fundit duhet të marrë masë ose të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht ato ose në të kundërt kërkesat në fjalë do të konsiderohet e ekzagjeruara dhe jo në përputhje me natyrën e kontratës objekt prokurimi, dhe autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për heqjen e këtij kriteri. Gjithashtu referuar nenit 79, pika 1, të ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, ku thuhet shprehimisht: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, autoriteti kontraktor duhet të sqarojë ofertuesit edhe për subjektet e akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë që lëshojnë këto certifikata.

Për këtë arsye, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK për procedurën e prokurimit menr.REF-76930-02-20-2026, me objekt: *“Implementimi i Sistemit të Ri Dixhital të Taksave dhe Tarifave Vendore”*, me fond limit 12,000,000.00 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar me datë 16-03-2026 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlore.
 2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Kreatx” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor, të kryejë modifikimet dhe sqarimet e dokumentave të tenderit në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet dhe sqarimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 4. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Kreatx” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiorent Zguro

